Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti/Enti kontraktor ose operatorët ekonomikë, përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit te Kontratës.

**Seksioni II:** **Shtojcat**

Seksioni II përfshin Shtojcat, të cilat duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e ofertës së tij, si dhe Shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor si, specifikimet teknike, termat e references, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit.

**Seksioni III.** **Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)**

**Seksioni III** përmban Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e sigurimit të kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre.

**Seksioni IV:** **Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit**

Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

## Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

## A. TË PËRGJITHSHME

**1. Objekti i prokurimit**

Objekti i procedurës së prokurimit, si dhe numri i kontratave (Loteve) dhe objektet e tyre përcaktohen në Njoftimin E Kontratës.

1. Përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë, përkufizimet dhe interpretimet në këto Dokumente të Tenderit do të jenë sipas përcaktimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPP).

**2. Operatorët Ekonomikë të përshtatshëm**

**a)** "Operator ekonomik" është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre dhe organizatat jofitimprurëse, të cilat ofrojnë kryerjen e punëve, furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve në treg, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si "Udhëzimet").

Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):

1.1 të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare;

1.2 BOE i bashkëlidh Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.

b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të cojë në refuzimin e Ofertës.

**3. Sqarimi i Dokumenteve të Tenderit**

Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti/enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht

që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti/Enti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

**4. Ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit**

1. Në çdo kohë para afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i ndryshojë Dokumentet e Tenderit duke hartuar një shtojcë, me këto ndryshime.
2. Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë sic është bërë publikimi i Dokumentave të Tenderit.
3. Nëse ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit për pranimin e Ofertave, autoriteti apo enti kontraktor mund të zgjasin afatin për pranimin e ofertave. Nëse dokumentet e tenderit ndryshohen në gjysmën e dytë të afatit për paraqitjen e ofertave, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin e fundit për paraqitjen e ofertave me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

## B. PËRGATITJA E OFERTAVE

**1. Shpenzimet e ofertimit**

Operatori Ekonomik përballon të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës së tij, dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk ka detyrime apo përgjegjësi për këto shpenzime, pavarësisht nga zhvillimi apo rezultati i procedurës.

**2. Gjuha e Ofertës**

Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në Njoftimin e Kontratës.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe.

Në procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e

dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze.

**3. Dokumentet përbërëse të Ofertës**

Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti kontraktor.

**4. Formularët e tenderit dhe Listat e Çmimeve**

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshën dhe i nënshkruar nga Personi (at) e Autorizuar.

**5. Ofertat Alternative**

Përveç nëse përshkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh.

**6. Çmimet**

1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës Ekonomike do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.

2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të kryhen dhe çmimin e tyre.

3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Shërbimet pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

5. Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

**7. Monedhat**

Monedha (at) e ofertave dhe monedha (at) e pagesës do të jenë siç specifikohet në njoftimin e kontratës.

**8. Provueshmëria e Kualifikimeve të Operatorit Ekonomik**

Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat.

**9. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës**

1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontratës pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.
2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërën nga format e mëposhtme:

   a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor;

   b) Garanci bankare;

   c) Garanci sigurimi.

   Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.
3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t’i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton

Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti/Entin Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën.

Nëse autoriteti/Enti kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet.

**10. Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave**

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

## D. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

**11. Paraqitja e Ofertave**

11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualet përkatëse.

11.2 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vetëm ofertën origjinale të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për kryerjen e Shërbimeve; Njoftimi Nr. __.

**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA ------------- d/m/v, në orën------------”.**

**12. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave**

Oferta duhet të paraqitet brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor. Nëse autoriteti/enti zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.

Data e hapjes së ofertave do të jetë e njëjtë me afatin e fundit të paraqitjes së ofertave. Nëse për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti/enti kontraktor në kohën e fillimit të procedurës, është e pamundur të respektohet afati për hapjen e ofertave nga autoriteti ose enti kontraktor, arsyeja duhet të dokumentohet dhe të caktohet një datë e re për hapjen e ofertave.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.

**13. Ofertat me vonesë**

Autoriteti/Enti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës. Sistemi i prokurimit elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.

**14. Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimet**

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e tij, në cdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimit të ofertave.

2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit/Entit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM OFERTE" ose "TËRHEQJE OFERTE".

3. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave.

**15. Hapja e Ofertave**

Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit.

## E. SHQYRTIMI I OFERTAVE

**16. Konfidencialiteti**

Autoriteti/enti kontraktor duhet të ruaj konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së.

**17. Sqarimi i ofertave**

Autoriteti/Enti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkese nga Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korrigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.

**18. Përgjegjshmëria e ofertave**

1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

(a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;

(b) "**Rezervim**" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe

(c) "**Mospranim"** është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

## F. VLERËSIMI I OFERTAVE

**19. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik**

1. Për një pjesë të kritereve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklarate, ku shprehet se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për

këtë bazë të dhënash. Operatori ekonomik mund të përdorë një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetdeklarim.

Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

**20. Konvertimi në valutë të vetme**

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

**21. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kritereve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

**Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:**

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të kostos, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterittë çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

Po = Pk1+Pk2+Pk3+.....

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

**a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:**

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 ____Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

**b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:**

Pk1= Ok1 x Pmaxk1 /Vmax k1

Vmaxk1_____Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 ______ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, autoritetet/entet kontraktore mund të përdorin kriteret e vlerësimit, si më poshtë:

**Propozimi Teknik do të vlerësohet deri në 80 pikë**

**Kriteret e Vlerësimit** **Pikët**

**(i) Përvoja per Punë të Ngjashme të operatorit ekonomik**

**Nënkriteret**[1]

**i/a Përvoja për punë të ngjashme**

Operatorët ekonomikë, mund të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

**i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë**

Operatorët ekonomikë mund të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

**(ii) Metodologjia e Propozuar**

**Nënkriteret**

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

ii.c. Organizimi i Stafit

**ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia:** Operatori ekonomik duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve, të paraqesin problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, duhet të shpjegohet metodologjia që propozojnë të adoptojë dhe të paraqesin kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës

**ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:** Operatori ekonomik duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke

[1] *Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit nënkritereve.*

treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret.

**ii/c. Organizimi dhe Stafi:** Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit të tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

**(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar**

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b. Eksperienca në fushën përkatëse

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

2. **Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:**

**Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë**

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik
Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar
Ç – Çmimi Ofertues i Radhës *(duke filluar nga çmimi më i ulët)*

**Pe = 100 x Çu / Ç**
(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

**Vlerësimi përfundimtar**

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

**Pesha për Propozimin Teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8)**

**pesha për Propozimin Ekonomik: Y = (pikët e propozimit ekonomik x 0.2)**

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

**Oferta më e mirë = X + Y**

**Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

**SHËNIM:** 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3.Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

**(a)** Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

**(b)** Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

**(c)** Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë

që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përllogaritjen e zërave të ofertës.

**22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta**

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara marrjes së një vendimi lidhur me kualifikimin ose moskualifikimin e tyre, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me nenin 93 të LPP-së..

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + … On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ......... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij Elektronike do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes se shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## D. DHËNIA E KONTRATËS

**23. Njoftimi i Fituesit**

Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij elektronike është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;

b) garanci bankare

c) garanci nga shoqëri sigurimi.

## DH. ANKESAT

**25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në sistemin Elektronik të Aneksave.

   Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t’i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## E. ANULIMI I PROCEDURËS

**26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

   a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

   b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

   c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

   d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

   e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

   Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve te Përzgjedhjes se Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

**Shtojca 1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE[2]**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

**(a)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

**(b)** Ne **[*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*)**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*]**.

**(c)** Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

**(d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

[2] Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

**(e)** Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ------------ **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

**(f)** Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ------------ **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

| | |
|---|---|
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |
| **Datë _________________** | |

**Shtojca 2**.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT**

**Data**: ___________________________________

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____________________________________

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): ___________________________________________________

**Monedha**: ____________

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Skeduli cmimit

| ***1*** | ***2*** | ***3*** | ***4*** | ***5*** | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike** | **Sasia** | **çmimi për njësi** | **Çmimi total (*3* x *4X*)** | |
| 1. | | | | | |
| 2. | | | | | |
| 3. | | | | | |
| 4 | | | | | |
| | **Çmimi total** | | | | _____________ |

| | |
|---|---|
| **Çmimi Neto pa TVSH** | |
| **TVSH (%)** | |
| **Çmimi total me TVSH:** | |
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |

| | |
|---|---|
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |
| **Datë _________________** | |

**Sqarim:** Ofertuesi duhet të paraqesë ofertën ekonomike në përputhje me Aneksin 2 bashkëlidhur këtij dokumenti.

**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

## Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 5.**

*([3]Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)*

**DEKLARATË**

**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti/Enti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Unë i nënshkruari _____________________, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "............................................." për procedurën e prokurimit me objekt______________ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "…………………………………….." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti/Enti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt ………është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës ________________**

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

[3] *Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.*

**Shtojca 6.**

[ *Shtojca duhet të plotësohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

**FORMULAR I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**SHËRBIME KËSHILLIMI PËR MBËSHTETJEN E ZHVILLIMIT TË KUADRIT STRATEGJIK DHE OPERACIONAL TË BANKËS SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT**

| | |
|---|---|
| **Autoriteti Kontraktor** | Banka Shqiptare e Zhvillimit (BSZH) |
| **Detyrë** | Këshillim Strategjik, Planifikim Biznesi, Zbatim dhe Mbështetje PMO |
| **Kohëzgjatja e Kontratës** | Maksimumi Gjashtëmbëdhjetë (16) muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës |
| **Afati i përfundimit të Shtyllës 1** | Jo më vonë se katër (4) muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës |
| **Objektivi i Gatishmërisë Operacionale** | Jo më vonë se dhjetori 2026, përveç nëse rregullohet në PMP-në e miratuar |

## Qëllimi dhe Natyra i Termave të Referencës

Këto Terma Reference përcaktojnë objektivat, Fushën e Veprimit, rezultatet, afatet, modalitetet e zbatimit, standardet e cilësisë, provat e verifikimit dhe procedurat e certifikimit për angazhimin e një Kontraktori i cili do të mbështesi Bankën Shqiptare të Zhvillimit në zhvillimin e kuadrit të saj strategjik dhe operacional.

Termat e Referencës e konkretizojnë Fushën e Veprimit ekzistues të Punës në një instrument të bazuar në një proces me hartimin e dokumenteve konkrete të cilat për finalizimin e tyre kërkojnë miratimin e BSZH. Qëllimi është që BSZH-ja të ketë mundësi të verifikojë përmbushjen e çdo detyre, të certifikojë produktet e dorëzuara dhe të lidhë pagesën me produkte të prekshme, të cilat shoqërohen me dokumentacion dhe prova mbështetëse. Termat e Referencës mbizotërojnë mbi përshkrimet e përgjithshme, aty ku ato përcaktojnë afate specifike, kritere pranimi, kërkesa për prova ose procedura certifikimi.

- Termat e Referencës kanë përparësi ndaj përshkrimeve të përgjithshme, sidomos në çdo rast kur ato përcaktojnë afate konkrete, kritere pranimi, kërkesa për prova mbështetëse ose procedura certifikimi.
- Të gjitha afatet llogariten nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës, e përcaktuar si T0, përveç nëse një afat tjetër është dakordësuar në mënyrë të shprehur në Kontratë ose në Planin e miratuar të Menaxhimit të Projektit
- Asnjë produkt i dorëzuar nuk do të konsiderohet i përfunduar vetëm në bazë të prezantimit ose diskutimit të tij. Produkti do të konsiderohet si i përfunduar kur dokumentet e dorëzuara shqyrtohen nga BSZH, komentet e përcjella korigjohen dhe bëhet pranimi i tyre formal dhe në mëyrë të shprehur. Kur është e aplikueshme, produkti duhet edhe që të certifikohet.

## 2. Sfondi dhe Konteksti Institucional

Pas miratimit të ligjit *"Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit",* më 17 mars 2025, dhe krijimit të Bankës Shqiptare të Zhvillimit më 17 dhjetor 2025, BSZH po vijon procedurat e konsolidimit të saj si Institucioni Promovues Kombëtar. Mandati i saj qëndron në mbështetjen e zhvillimit të sektorëve me prioritet kombëtar, lehtësimin e aksesit në financë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, mbështetjen e infrastrukturës strategjike dhe mobilizimin kapitalit publik dhe privat.

BSZH është krijuar duke u bazuar tek institucionet publike evropiane të zhvillimit, si Cassa Depositi e Prestiti, Bpifrance dhe KfË. Si pasojë e këtij fakti, kërkohet një Kontraktor me ekspertizë të provuar në hartimin e strategjive të bankave të zhvillimit, planifikimin e biznesit; organizimin institucional, produktet financiare, mekanizmat e financimit, menaxhimin e riskut, TIK/operacionet, qeverisjen dhe mbështetjen e PMO-së.

## 3. Objektivat e Detyrës

- Hartimi i një kuadri gjithëpërfshirës strategjik, institucional dhe operacional si dhe i një plani biznesi për BSZH-në, duke u mbështetur në planin paraprak dhe në kontekstin institucional shqiptar. Mbështetja e BSZH-në në kanalizimin e vendimeve strategjike në plane konkrete operative, dokumente qeverisje, produkte konkrete, politika, procese dhe plane zbatimi.
- Ofrimi i mbështetjes ndaj PMO në kuadër të koordinimit të linjave të punës, ndjekjes së faktorëve që krijojnë varësi ndërmjet aktiviteteve, menaxhimit të çështjeve të evidentuara, përgatitjes së raporteve të progresit dhe mbështetjes gjatë procesese të vendimmarrjes nga strukturat e qeverisjes së BSZH-së.
- Përcaktimi i dokumentacionint, kritereve të pranimit dhe provave të kërkuara, në mënyrë të tillë që BSZH mund ta ketë të mundur që të verifikojë, pranojë, certifikojë dhe paguajë për detyrat dhe rezultatet e arritura
- Transferimi i njohurive te personeli i BSZH-së, në mënyrë që, pas përfundimit të detyrës, BSZH-ja të ketë kapacitetet e nevojshme për të vijuar, mirëmbajtur dhe përditësuar në mënyrë të pavarur kuadrin strategjik dhe operacional.

## 4. Përkufizime

| Termi | Përkufizim |
|---|---|
| **BSZH** | Banka Shqiptare e Zhvillimit. |
| **Kontraktor** | Entiteti, konsorciumi ose sipërmarrja e përbashkët që ka fituar Kontratën. |
| **Data e Fuqisë në Fuqi të Kontratës / T0** | Data nga e cila fillojnë të llogariten afatet kontraktuale. |
| **Menaxher i Ekzekutimit të Kontratave** | Përfaqësuesi i autorizuar i BSZH-së, përgjegjës për administrimin e kontratës, verifikimin e përmbushjes së rezultateve të dorëzuara dhe lëshimin e certifikatave përkatëse të performancës. |
| **Udhëheqës Teknik** | Partneri i caktuar nga Kontraktori si pika e vetme e përgjegjësisë për ofrimin e shërbimeve. |

| Termi | Përkufizim |
|---|---|
| **PMP** | Plani i Menaxhimit të Projektit i përgatitur për çdo ndërhyrje në projekt dhe i cili miratohet nga BSZH përpara ekzekutimit të tij. |
| **RSP** | Raporti i Statusit të Progresit i dorëzuar periodikisht për çdo ndërhyrje aktive. |
| **RACI** | Matrica e caktimit të përgjegjësisë e cila sqaron detyrat dhe përgjegjësitë për secilin subjekt, produktin që duhet të dorëzohet, vendimmarrjen ose miratimin. |
| **Produkt** | Çdo dokument, model, raport, prezantim, politikë, procedurë, matricë, panel kontrolli, rezultat i seminarit ose rezultat tjetër i kërkuar sipas ToR ose një PMP të miratuar. |
| **Kriteret e Pranimit** | Kriteret objektive që duhet të përmbushen përpara se BSZH të miratojë një produkt. |
| **Dokumentactioni Provues** | Dokumentacioni mbështetës i cili paraqitet me secilin produkt, që mundëson verifikimin dhe certifikimin e punës. |
| **Certifikata e Performancës** | Konfirmim zyrtar i lëshuar nga BSZH që një projekt, detyrë ose produkt është përfunduar dhe pranuar sipas kërkesave. |
| **Ditë pune** | Një ditë tjetër përveç të shtunës, të dielës ose një dite feste zyrtare në Shqipëri. |
| **Detyra/aktivitete të ngjashme ose të krahasueshme** | nënkupton shërbimet e konsulencës që mbulojnë një ose më shumë nga fushat e strategjisë, planifikimit të biznesit, strukturës institucionale, qeverisjes, mbështetjes për PMO-në dhe zbatimin, zhvillimit të produkteve, administrimit të riskut, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, burimeve njerëzore, thesarit, kursimeve postare ose operacioneve, të ofruara për institucione financiare, përfshirë institucionet kombëtare promovuese, bankat e zhvillimit, bankat tregtare, institucionet financiare publike, institucionet financiare ndërkombëtare ose subjekte të tjera me mandate të krahasueshme për adresimin e dështimeve të tregut, veçanërisht kur këto institucione veprojnë sipas ose në përputhje me kuadrin rregullator dhe statistikor të Bashkimit Evropian, si EBA, BQE dhe Eurostat/ESA, në vendet anëtare të BE-së ose në vendet kandidate për anëtarësim në BE. |

## 5. Struktura e Detyrave dhe Rrjedhat e Punës

Detyrat do të strukturohet mbi dy shtylla kryesore dhe mbi një kuadër ndërsektorial për PMO-në, verifikimin dhe certifikimin:

- **Shtylla 1 – Këshillimi Strategjik:** kuadri strategjik, projektplani, plani i zhvillimit institucional dhe operacional, plani i biznesit, analiza krahasuese, modeli financiar dhe materialet mbështetëse për vendimmarrjen strategjike.
- **Shtylla 2 – Zbatimi dhe Mbështetja për PMO-në:** operacionalizimi i kuadrit strategjik, ngritja institucionale, koordinimi i linjave të punës, mbështetja për produktet, riskun, TIK-un, burimet njerëzore, si dhe monitorimi i zbatimit.
- **Kuadri ndërsektorial i Verifikimit dhe Certifikimit:** regjistri i produkteve të, paketat e provave mbështetëse, kriteret e pranimit, procesi i miratimit, kontrolli i cilësisë dhe raportimi përmbyllës.

## 6. Kohëzgjatja e përgjithshme dhe afatet e realizimit të etapave kryesore

Kohëzgjatja e përgjithshme e shërbimeve nuk duhet të jetë më e gjatë se gjashtëmbëdhjetë (16) muaj nga T0. Shtylla 1 duhet të përfundojë jo më vonë se T0 + 4 muaj. Mbështetja për Shtyllën 2 dhe për PMO-në mund të vazhdojë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, përveçse kur parashikohet ndryshe në një PMP të miratuar. Puna në kuadër të Shtyllës 1 dhe Shtyllës 2 mund të nisë dhe të zhvillohet në mënyrë paralele. Kalendari tregues i etapave kryesore i paraqitur më poshtë zbatohet, përveç rasteve kur BSZH-ja miraton një PMP të rishikuar.

| Etapa kryesore | Afati i përfundimit | Produkti kryesor | Baza e verifikimit nga BSZH-ja | Kriteret për certifikimin/pagesën |
|---|---|---|---|---|
| M0 – Fillimi i kontratës | T0 + 5 ditë pune | Takimi fillestar, dokumenti i mobilizimit dhe protokolli i komunikimit | Akti i nënshkruar për fillimin e detyrës, lista e palëve të interesuara dhe kërkesa fillestare për informacion/dokumentacion | Asnjë pagesë, përveçse kur parashikohet në PMP-në e miratuar |
| M1 – Inception / Master PMP | T0 + 15 ditë pune | PMP-ja kryesore, modeli i qeverisjes, regjistri i produkteve, si dhe dokumentet tip për regjistrimin e risqeve dhe çështjeve | PMP-ja e miratuar, plani i punës, grafiku Gantt, plani i burimeve dhe matrica e pranimit | Parakusht për aktivizimin e ndërhyrjeve në projekt |
| M2 – Analizimi dhe vlerësimi i gjendjes bazë | T0 + 1 muaj | Vlerësimi i gjendjes aktuale dhe analiza e boshllëqeve | Raporti analizues, matrica e analizës së dokumenteve, regjistri i intervistave dhe regjistri i provave/dokumentacionit mbështetës | Certifikimi i dorëzimit, nëse produkti pranohet nga BSZH-ja |

| Etapa kryesore | Afati i përfundimit | Produkti kryesor | Baza e verifikimit nga BSZH-ja | Kriteret për certifikimin/pagesën |
|---|---|---|---|---|
| M3 – Opsionet strategjike dhe validimi i planit | T0 + 2 muaj | Dokumenti i opsioneve strategjike dhe projektplani | Dokumenti i opsioneve strategjike, regjistri i vendimeve, procesverbali i seminarit dhe gjurmuesi i komenteve të BSZH-së. | Certifikimi i rezultatit strategjik të ndërmjetëm |
| M4 – Draft-plani institucional dhe operacional dhe modeli financiar | T0 + 3 muaj | Draft-plani institucional dhe operacional, draft-plani i biznesit dhe modeli financiar | Drafti i planit institucional/operacional dhe të biznesit, modeli financiar, dokumenti i varianteve kryesore të modelimit dhe analiza e sensitivetit për skenarët kryesorë. | Certifikimi kryhet vetëm pas dorëzimit të dokumenteve në format të modifikueshëm dhe dokumentimit të sugjerimeve përkatëse. |
| M5 – Paketa përfundimtare e Shtyllës 1 | T0 + 4 muaj | Plani përfundimtar, plani institucional/operacional, plani 3-vjeçar i biznesit dhe materiali i prezantimit për strukturat qeverisëse | Versionet përfundimtare të dokumenteve në format të modifikueshëm, matrica e konsoliduar e adresimit të komenteve dhe prezantimi final për shqyrtim/miratim nga strukturat vendimmarrëse të BSZH-së. | Certifikim i detyrueshëm përpara pagesës për Shtyllën 1 |
| M6 – Kuadri operacional, Grupi 1 | T0 + 6 muaj | Proceset prioritare, qeverisja dhe procedurat operative të PMO-së | Hartat e proceseve, draftet e politikave, matrica RACI dhe provat për miratimin | Certifikimi i paketës së produkteve të pranuara |
| M7 – Kuadri operacional, Grupi 2 | T0 + 9 muaj | Paketa e për produktet financiare, riskun, financimin, thesarin, TIK-un, burimet njerëzore | Produktet e miratuara për secilën rrjedhë pune, modelet përkatëse dhe paketat e provave mbështetëse | Certifikimi i paketës së produkteve të pranuara |

| Etapa kryesore | Afati i përfundimit | Produkti kryesor | Baza e verifikimit nga BSZH-ja | Kriteret për certifikimin/pagesën |
|---|---|---|---|---|
| | | dhe organizimin institucional. | | |
| M8 – Rishikimi i gatishmërisë operacionale | Jo më vonë se dhjetori 2026 ose T0 + 12 muaj, cilado datë që vjen më herët, përveçse kur miratohet ndryshe | Raporti i vlerësimit të gatishmërisë operacionale dhe gjurmuesi i veprimeve të nevojshme për lançimin | Lista e kontrollit të gatishmërisë operacionale, regjistri i çështjeve të hapura, plani i masave zbutëse dhe materiali i prezantimit për menaxhimin e BSZH-së. | Rishikimi dhe certifikimi i gatishmërisë |
| M9 – Stabilizimi dhe transferimi i njohurive | T0 + 15 muaj | Trajnimi, mbështetja operative dhe përmirësimet përfundimtare | Materialet e trajnimit, listat e pjesëmarrjes, manualet e përditësuara dhe ndryshimet përfundimtare | Parakusht për mbylljen e kontratës |
| M10 – Mbyllja përfundimtare | T0 + 16 muaj | Raporti përfundimtar i mbylljes së projektit dhe indeksi i plotë i produkteve | Raporti i mbylljes, arkivi i plotë i provave dhe certifikatat e pranimit | Certifikata përfundimtare dhe pagesa përfundimtare |

## 7. Objektivi kryesor i shërbimeve

### 7.1 Shtylla 1 – Këshillimi Strategjik

• Validimin e planit paraprak dhe të modeleve strategjike për funksionimin e BSZH-së, në lidhje me mandatin, misionin, shtrirjen operacionale, sektorët e synuar, kategoritë e klientëve të përshtatshëm, llojet e produkteve, modelin e financimit dhe logjikën e ndikimit zhvillimor.
• Përgatitjen e një analize krahasuese të institucioneve kombëtare promovuese dhe bankave përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare të zhvillimit, me fokus te modelet operative, qeverisjen,

llojet dhe ofertën e produkteve, burimet e financimit, administrimin e riskut, kuadrin mbikëqyrës, modelet e kursimeve postare dhe mandatet institucionale.

• Hartimin e Projektplanit dhe të Planit të Zhvillimit Institucional dhe Operacional, duke mbuluar veprimtaritë e biznesit, burimet dhe përdorimin e fondeve, organizimin institucional, qeverisjen, modelin operativ, planin e zbatimit dhe trajektoren e zhvillimit të BSZH-së.

• Hartimin e Planit trevjeçar të Biznesit, duke përfshirë parashikimet financiare, përdorimin e kapitalit, strukturën e kostove, supozimet për të ardhurat, analizat e sensitivitetit, supozimet mbi investimet e thesarit me risk të ulët/pa risk, skenarët e financimit dhe testet e stresit.

• Përgatitjen e materialeve mbështetëse për vendimmarrje për strukturat menaxhuese dhe qeverisëse të BSZH-së, duke përfshirë prezantimet për bordet/organet vendimmarrëse, përmbledhjet ekzekutive dhe rekomandimet për zbatim.

### 7.2 Shtylla 2 – Zbatimi dhe Mbështetja e PMO-së

- Ngritja dhe vënia në funksionim e kornizës PMO, duke përfshirë drejtimin e linjës së punës, dokumentet tip të raportimit, menaxhimin e raporteve të varësisë, menaxhimin e problemeve me rëndësi, ndjekjen e rrezikut dhe monitorimin e momenteve kryesore.
- Mbështetja e linjës së punës ligjore dhe të qeverisjes duke identifikuar rregulloret e brendshme të nevojshme, dokumentet e qeverisjes, përgjegjësite e deleguara, strukturat e komiteteve, linjën e vendimmarrjes dhe kërkesat e përputhshmërisë.
- Mbështetja e financimit dhe e linjës së veprimtarisë financiare, duke përfshirë planifikimin e kapitalizimit, rregullimet për llogaritë e thesarit, rregullimet për llogaritë e letrave me vlerë, bashkëpunimin me Bankën e Shqipërisë, ndërveprimin me Ministrinë e Financave dhe kërkesat për fizibilitetin dhe zbatimin e kursimeve postare.
- Mbështetja e linjës së punës për biznesin dhe zhvillimin e produkteve, duke përfshirë konceptimin e produkteve, përcaktimin e kritereve të pranueshmërisë, analizën e tregjeve të synuara, logjikën e çmimit, mekanizmat e garancisë, kriteret e gatishmërisë për huadhënie të drejtpërdrejtë dhe planet e ndarë në fazë për aktivizimin e produkteve.
- Mbështetja e linjës së punës për riskun dhe mbikëqyrjen, duke përfshirë zhvillimin e kuadrit praktik të administrimit të riskut, përcaktimin e oreksit për risk, hartimin e politikave dhe njësive matëse të riskut, përgatitjen e dokumenteve tip të raportimit, mjeteve bazë të vlerësimit dhe materialeve të nevojshme për ndërveprimin me autoritetet mbikëqyrëse.
- Mbështetja e linjës së punës për TIK-un dhe operacionet, duke përfshirë përcaktimin e strategjisë së TIK-ut, vlerësimin e mundësive për outsourcing, identifikimin e sistemeve prioritare, identifikimin e proceseve operative, përgatitjen e SOP-ve, përcaktimin e kërkesave për të dhënat dhe identifikimin e faktorëve kryesorë të varësisë për zbatim.
- Mbështetja e linjës së punës për burimet njerëzore dhe organizimin institucional, përmes miratimit të strukturës organizative, planifikimit me faza të nevojave për personel/FTE, përcaktimit të profileve të punës, hartimit të matricave të aftësive, identifikimit të kërkesave për integrimin e personelit dhe përcaktimit të proceseve kryesore të brendshme.
- Mbështetja e BSZH-së në koordinimin dhe ndërveprimin me palët e jashtme të interesit, përfshirë institucionet publike, partnerët ndërkombëtarë, ndërmjetësit financiarë, Postën Shqiptare, Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe palë të tjera përkatëse, duke ruajtur në çdo rast autoritetin formal vendimmarrës të BSZH-së.

*Informacioni i mësipërm është i detajuar më tej në Shtojcën E të ToR-së.*

## 8. Produktet, afatet përkatëse, provat mbështetëse dhe kriteret e pranimit

Matrica e mëposhtme është orientuese. Çdo produkt i dorëzuar duhet të dorëzohet së bashku me një Paketë Provash. BSZH mund të refuzojë shqyrtimin ose certifikimin nëse Paketa e Provave është e paplotë.

| *Kod i* | *Produkti i dorëzueshëm* | *Afati* | *Përmbajtja* | *Dokumentacioni/provat mbështetëse të kërkuara për verifikim* | *Kriteret e pranimit / Baza për certifikim* |
|---|---|---|---|---|---|
| D0.1 | Procesverbali i takimit fillestar dhe dokument i mobilizimit | T0 + 5 ditë pune | Agjenda e takimit fillestar, pjesëmarrësit, struktura e dakordësuar e komunikimit midis organeve, kanalet e komunikimit dhe hapat vijues. | Procesverbal i nënshkruar ose i konfirmuar; lista e pjesëmarrësve; matrica e kontakteve; lista fillestare e kërkesave për informacion. | Konfirmon mobilizimin dhe mundëson fillimin e fazës fillestare. |
| D1.1 | Plani Kryesor i Menaxhimit të Projektit (Master PMP) | T0 + 15 ditë pune | Plani i punës, grafiku Gantt, linjat e punës, etapat kryesore, plani i burimeve, elementët e varësisë, matrica RACI, regjistrat e riskut/çështjeve/ndryshimeve, kalendari i raportimit, regjistri i produkteve dhe plani i faturimit. | PMP i modifikueshëm; grafiku Gantt; matrica RACI; alokimi i CV-ve të; tabela e angazhimit; regjistri i riskut dhe çështjeve; dokumenti tip për kërkesat për ndryshim. | Miratohet me shkrim nga BSZH-ja. Asnjë ndërhyrje e bazuar në projekt nuk mund të vijojë pa PMP të miratuar ose Urdhër Dorëzimi. |
| D1.2 | Matrica e pranimit dhe certifikimit | T0 + 15 ditë pune | Kriteret e pranimit për çdo produkt, autoritetet kompetente për shqyrtim, kërkesat për prova mbështetëse, momentet që aktivizojnë certifikimin dhe lidhja me pagesën. | Matrica në Word/Excel; rrjedha e miratimit; personat/strukturat e caktuara për miratim; dokumenti tip i certifikatës. | Duhet të miratohet nga BSZH-ja dhe të përdoret për të gjitha certifikimet pasuese. |

| *Kodi* | *Produkti i dorëzueshëm* | *Afati* | *Përmbajtja* | *Dokumentacioni/provat mbështetëse të kërkuara për verifikim* | *Kriteret e pranimit / Baza për certifikim* |
|---|---|---|---|---|---|
| D2.1 | Raport i i shqyrtimit së dokumenteve dhe analizës | T0 + 1 muaj | Shqyrtimi i planit paraprak ekzistues, bazës ligjore, kontekstit të qeverisjes, supozimeve të biznesit, boshllëqeve operacionale, gatishmërisë së linjave të punës dhe boshllëqeve të të dhënave. | Lista e dokumenteve të shqyrtuara; matrica e shqyrtimit; shënimet e intervistave; regjistri i boshllëqeve; regjistri i supozimeve. | Përmbajtja e plotë e dokumenteve, gjurmueshmëria e burimeve dhe rekomandimet praktike për mbylljen e boshllëqeve. |
| D2.2 | Harta e palëve të intereuara dhe e linjave të punës | T0 + 1 muaj | Palët e interesit, roli i secilës linjë pune, varësitë në zbatim, pikat e kontaktit dhe rruga për zgjidhjen e ceshtjeve me rëndësi. | Regjistri i palëve të interesit; matrica RACI; kartat e linjave të punës; procesverbalet që konfirmojnë rolet. | Përgjegjësi të qarta të kuadrit qeverisës dhe PMO e përdorshme. |
| D3.1 | Analiza krahasuese e NPI-ve/bankave të zhvillimit | T0 + 6 javë | Analizë krahasuese e CDP-së, Bpifrance, KfW-së dhe institucioneve të tjera përkatëse, me interes për Shqipërinë. | Burimet e të dhënave; tabelat krahasuese; shënimi në lidhje me metodologjinë; kufizimet; përmbledhja ekzekutive. | E bazuar në prova dhe e lidhur drejtpërdrejt me veprimtarinë e BSZH-së. |
| D3.2 | Dokumenti i opsioneve strategjike dhe vendimmarrjes | T0 + 2 muaj | Opsionet strategjike, interpretimi i mandatit, Fushën e veprimit të produkteve, rrugët e financimit, përcaktimi i fazave të zbatimit dhe pikat e vendimmarrjes. | Dokumenti i vendimmarrjes; prezantimi; procesverbalet e seminarit; regjistri i vendimeve; gjurmuesi i komenteve. | BSZH-ja mund ta përdorë dokumentin për vendimmarrje në nivel menaxhimi/qeverisjeje. |

| *Kodi* | *Produkti i dorëzueshëm* | *Afati* | *Përmbajtja* | *Dokumentacioni/provat mbështetëse të kërkuara për verifikim* | *Kriteret e pranimit / Baza për certifikim* |
|---|---|---|---|---|---|
| D4.1 | Plani paraprak i miratuar dhe modeli operacional i synuar | T0 + 10 javë | Misioni, modeli operacional, qeverisja, linjat e punës, plani i ndarë me faza, llojet e produkteve, koncepti i financimit, arkitektura e riskut dhe kontrollit. | Dokumenti i planit paraprak; arkitektura në nivel procesesh; regjistri i vendimeve; gjurmueshmëria me planin paraprak fillestar. | Përputhshmëri me mandatin e BSZH-së, fizibilitet, qartësi dhe gjurmueshmëri. |
| D4.2 | Draft-Plani Institucional dhe Operacional | T0 + 3 muaj | Logjika operative/institucinale, shtyllat strategjike, organizimi, udhërrëfyesi pwr zbatimin, kuadri i financimit/burimeve të financimit dhe rruga e zhvillimit të produkteve. | Dokument Word i modifikueshëm; prezantim PowerPoint; anekse; burimet; gjurmuesi i komenteve. | Draft i gatshëm për strukturat vendimmarrëse/drejtuese, me parashikime të plota dhe pasoja të qarta zbatimi. |
| D4.3 | Draft-Plani i Biznesit dhe modeli financiar | T0 + 3 muaj | Parashikimet trevjeçare, supozimet për të ardhurat dhe kostot, përdorimi i kapitalit, skenarët e financimit, analizat e ndjeshmërisë dhe testet e stresit. | Model financiar i modifikueshëm në Excel; dokumenti i supozimeve; formula të hapura kur ato janë të përshtatshme; udhëzuesi i modelit; rezultatet e analizës së sensivitetit. | Modeli është transparent, i qëndrueshëm, i auditueshëm dhe i lidhur me planin narrativ. |
| D5.1 | Plani Institucional dhe Operacional përfundimtar | T0 + 4 muaj | Plani përfundimtar që integron komentet e BSZH-së dhe vendimet strategjike të dakordësuara. | Versioni përfundimtar i pastër në Word; versioni me ndryshime/ose me zgjidhjen e komenteve; | Pranim formal me shkrim nga BSZH-ja. |

| *Kodi* | *Produkti i dorëzueshëm* | *Afati* | *Përmbajtja* | *Dokumentacioni/provat mbështetëse të kërkuara për verifikim* | *Kriteret e pranimit / Baza për certifikim* |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | prezantimi përfundimtar; dokumenti i miratimit. | |
| D5.2 | Plani përfundimtar i biznesit dhe modeli financiar | T0 + 4 muaj | Plani përfundimtar trevjeçar, analiza e sensivitetit, supozimet dhe përmbledhja për menaxhimin. | Modeli përfundimtar në Excel; pjesa narrative në PDF/Word; regjistri i supozimeve; historiku i versioneve; regjistri i ndryshimeve. | Pranim formal i paketës financiare përfundimtare të Shtyllës 1. |
| D5.3 | Paketa përfundimtare e mbylljes së Shtyllës 1 | T0 + 4 muaj | Indeksi i produkteve të Shtyllës 1, deklarata e përfundimit, çështjet e pazgjidhura dhe rekomandimet për Shtyllën 2. | Raporti i mbylljes së Shtyllës 1; indeksi i produkteve; provat për pranimin; kërkesa për certifikatë. | Baza për certifikatën e përmbushjes së rregullt të shërbimeve për Shtyllën 1. |
| D6.1 | Procedurat operative dhe dokumentet tip të PMO-së | T0 + 6 javë, më pas përditësime mujore | Kalendari i PMO-së,  dokumentet tip për zhvillimin e takimeve të organeve qeverisëse, regjistrat, rregullat e zgjidhjes së ceshtjeve me rëndësi dhe standardet e raportimit. | Dokumentet tip për RSP-në, regjistrin e çështjeve, regjistrin e risqeve, regjistrin e vendimeve, gjurmuesin e varësive në zbatim dhe gjurmuesin e veprimeve. | Dokumente tip të përdorshme nga BSZH-ja dhe të cilat mund të përdoren në mënyrë të vazhdueshme. |
| D6.2 | Raportet mujore të statusit të progresit | Çdo muaj, deri në ditën e | Progresi kundrejt planit, produktet e dorëzuara/miratuara, angazhimi, risqet, | RSP; grafiku Gantt i përditësuar; regjistrat; procesverbalet; | Miratimi nga BSZH-ja i RSP-së dhe regjistrave mbështetës. |

| *Kodi* | *Produkti i dorëzueshëm* | *Afati* | *Përmbajtja* | *Dokumentacioni/provat mbështetëse të kërkuara për verifikim* | *Kriteret e pranimit / Baza për certifikim* |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 5-të të punës të muajit pasardhës | çështjet, vendimet dhe plani për muajin vijues. | indeksi i produkteve të dorëzueshme. | |
| D6.3 | Gjurmues i javor i veprimeve | Çdo javë, brenda 2 ditëve pune pas takimit javor | Veprimet, përgjegjësitë, afatet, pengesat dhe çështjet me rëndësi. | Gjurmuesi i përditësuar; shënimet e takimit; prova e qarkullimit të veprimeve. | Ndjekje e gjurmueshme dhe zgjidhja e problemative me rëndësi në kohë. |
| D7.1 | Paketa e dokumenteve ligjore dhe të qeverisjes | T0 + 6 muaj; përditësime sipas nevojës | Lista e dokumenteve të qeverisjes, harta e komiteteve, autoritetet të cilave do i delegohen detyra, udhërrëfyesi i rregulloreve të brendshme dhe lista e kontrollit të përputhshmërisë. | Matrica e qeverisjes; draft-dokumentet; referencat ligjore; shënimet për shqyrtim; gjurma e miratimit. | Cilësia dhe plotësia e kuadrit qeverisës dhe të zbatimit të tij në praktikë |
| D7.2 | Paketa e financimit, thesarit dhe kursimeve postare | T0 + 9 muaj ose sipas fazave të përcaktuara në PMP | Burimet e financimit, kapitalizimi, llogaritë e thesarit, llogaria e letrave me vlerë, bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë/Ministrinë e Financave, modeli i biznesit për kursimet postare dhe inputet për projekt-aktin nënligjor. | Modeli i biznesit; shënimet rregullatore; procesverbalet me palët e interesit; analiza financiare; lista e kontrollit dhe zbatimit. | E mjaftueshme që BSZH-ja të vendosë për hapat vijues lidhur me financimin/thesarin /kursimet postare. |

| *Kodi* | *Produkti i dorëzueshëm* | *Afati* | *Përmbajtja* | *Dokumentacioni/provat mbështetëse të kërkuara për verifikim* | *Kriteret e pranimit / Baza për certifikim* |
|---|---|---|---|---|---|
| D7.3 | Paketa e biznesit dhe e produkteve | T0 + 9 muaj | Llojet e produkteve, lista me fazat e lançimit të produkteve, kriteret e pranueshmërisë, koncepti i garancisë, gatishmëria për huadhënie të drejtpërdrejtë dhe procesi i bashkëpunimit me bankat. | Fletët e produkteve; kriteret e pranueshmërisë; hartat e proceseve; analiza e tregut; lista e kontrollit për ndihmën shtetërore/përputhshmërinë. | Produktet janë të zbatueshme, të përcaktuara me faza dhe në përputhje me mandatin e BSZH-së. |
| D7.4 | Paketa e riskut dhe mbikëqyrjes | T0 + 9 muaj | Parimet e oreksit për risk, skema e politikës së riskut, mjetet/matricat bazë, dokumentet tip të raportimit dhe plani i ndërveprimit me mbikëqyrjen. | Kuadri i riskut; shënimet RAF; dokumentet tip; regjistri i riskut; plani i mbikëqyrjes. | Praktike dhe proporcionale me përfundimin e Fazës 1. |
| D7.5 | Paketa e TIK-ut dhe operacioneve | T0 + 9 muaj | Strategjia e TIK-ut, mundësitë për outsourcing, nevojat për të dhëna, sistemet prioritare, makroproceset dhe prioritetet për SOP-të. | Kërkesat e TIK-ut; hartat e proceseve; matrica RACI; draftet e SOP-ve; varësitë për vijimin e procesit të zbatimit. | E përdorshme dhe në përputhje me projektimin e produkteve dhe riskut. |
| D7.6 | Paketa e burimeve njerëzore dhe organizimit | T0 + 6 muaj; përditësime deri në T0 + 12 muaj | Miratimi i strukturës organizative, ndarja me faza i FTE-ve, profilet e punës, plani i integrimit dhe matrica e aftësive. | Struktura organizative; plani i personelit; dokumentet tip të profileve të punës; lista e kontrollit për integrimin; plani i trajnimit. | Mbështet rekrutimin dhe planifikimin e lançimit operacional. |
| D8.1 | Lista e kontrollit | Jo më vonë se | Gatishmëria sipas linjave të punës, | Lista e kontrollit të gatishmërisë; | I mundëson BSZH-së të vlerësojë |

| *Kodi* | *Produkti i dorëzueshëm* | *Afati* | *Përmbajtja* | *Dokumentacioni/provat mbështetëse të kërkuara për verifikim* | *Kriteret e pranimit / Baza për certifikim* |
|---|---|---|---|---|---|
| | dhe raporti i gatishmërisë operacionale | dhjetori 2026 ose T0 + 12 muaj | çështjet e hapura, varësitë kritike për zbatimin, pengesat, plani i masave zbutëse dhe pikat e vendimmarrjes për lançimin. | arkivi i provave; prezantimi për menaxhimin; regjistri i çështjeve të hapura. | gatishmërinë për lançimin operacional. |
| D9.1 | Paketa e transferimit të njohurive | T0 + 15 muaj | Sesione trajnimi, manuale dorëzimi, prezantime shpjeguese të modelit, prezantime shpjeguese të proceseve dhe transferimi i pronësisë/përgjegjësisë. | Materialet për trajnim; listat e pjesëmarrjes; regjistrimet, kur lejohen; regjistri i pyetjeve dhe përgjigjeve; lista e kontrollit për pranimin e dorëzimeve. | Ekipet e BSZH-së mund të mirëmbajnë dhe përditësojnë në mënyrë të pavarur rezultatet. |
| D10.1 | Raporti përfundimtar i mbylljes së projektit | T0 + 16 muaj | Lista e plotë e shërbimeve të kryera, produkteve, provave, miratimeve, çështjeve të pazgjidhura, rekomandimeve dhe mësimeve përfundimtare të nxjerra. | Raporti i mbylljes; indeksi i produkteve; kërkesat për certifikatë; struktura e arkivit; RSP-ja përfundimtare. | Baza për certifikatën përfundimtare të përmbushjes së rregullt të shërbimeve dhe fatura përfundimtare. |

## 9. Paketa e Provave të Kërkuara për Çdo Produkt të Dorëzuar

Çdo produkt i dorëzuar duhet të shoqërohet nga një Paketë Provash. Përveç nëse BSZH bie dakord ndryshe në PMP, Paketa e Provave duhet të përfshijë të paktën sa vijon:

- Letra e dorëzimit e cila identifikon kodin e dorëzimit, titullin, versionin, datën, përfaqësuesin e Kontraktorit dhe veprimin e kërkuar të BSZH-së.
- Dokument i modifikueshëm në formatin përkatës (Word, Excel, PoëerPoint, Visio ose format tjetër i miratuar) dhe versioni PDF kur është e nevojshme.

- Lista e kontrollit të përputhshmërisë që përputhet me rezultatet e dorëzuara kundrejt ToR, PMP dhe kritereve të pranimit.
- Matrica e komenteve që tregon komentet e BSZH-së, përgjigjen e Kontraktorit, veprimin e ndërmarrë dhe statusin.
- Regjistri i burimeve dhe supozimeve, duke përfshirë burimet e të dhënave, kufizimet, supozimet dhe shënimet me natyrë metodologjike.
- Procesverbalet e mbledhjeve, procesverbalet e seminareve, fletët e pjesëmarrjes dhe regjistrat e vendimeve ku rezultati pasqyron konsultimet ose vendimet.
- Modelet, formulat, dokumentet e punës, hartat e proceseve, panelet dhe shtojcat e nevojshme për të kryer audite dhe përdorim në të ardhmen nga BSZH.
- Deklaratë e sigurimit të cilësisë e nënshkruar nga Udhëheqësi Teknik i Kontraktorit që konfirmon shqyrtimin e brendshëm para dorëzimit.
- Regjistri i çështjeve të hapura dhe varësive të zbatimit, përfshirë çështjet që kërkojnë vendimmarrje nga BSZH-ja ose përgjigje/veprim nga palë të treta.
- Kërkesa e propozuar për certifikatë kur Kontraktori e konsideron produktin gati për pranim dhe certifikim.

## 10. Procedura e Pranimit, Rishikimit dhe Certifikimit

### 10.1 Dorëzimi

Kontraktori duhet të paraqesë çdo produkt përmes kanalit zyrtar të përcaktuar nga BSZH, së bashku me Paketën e Provave. Produktet të përcjella pa prova të plota mund të kthehen pa shqyrtim thelbësor.

### 10.2 Kontrolli fillestar i përmbajtjes së dokumenteve

BSZH mund të kryejë një kontroll fillestar të përmbajtjes së dokumenteve brenda pesë (5) ditëve pune. Nëse Paketa e Provave së Produktit është e paplotë, BSZH mund të kërkojë ridërgimin e tyre dhe periudha e shqyrtimit nuk fillon derisa të disponohet një Paketë e Plotë Provash.

### 10.3 Rishikimi thelbësor

Përveç nëse PMP përcakton ndryshe, BSZH duhet të japë komente brenda dhjetë (10) ditëve pune për produktet e zakonshme dhe brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune për produktet komplekse strategjike, financiare, ligjore, TIK ose të riskut.

### 10.4 Korrigjimet e kontraktorit

Kontraktori duhet të paraqesë një version të rishikuar brenda pesë (5) ditëve pune për produktet e zakonshme dhe brenda dhjetë (10) ditëve pune për produktet komplekse, përveç nëse BSZH përcakton një afat tjetër.

### 10.5 Pranimi

Pranimi do të konsiderohet si i vlefshëm vetëm nëse jepet nëpërmjet komunikimit formal me shkrim nga BSZH. Nuk zbatohet pranimi i heshtur.

## 10.6 Certifikatë e performancës

Pas pranimit, BSZH mund të lëshojë një Certifikatë për projektin, detyrën, paketën e produkteve ose për fazën përkatëse. Certifikata është parakusht për faturimin, përveç nëse Kontrata parashikon shprehimisht ndryshe.

## 10.7 Refuzimi ose pranimi me kusht

BSZH mund ta refuzojë një produkt të dorëzuar ose ta pranojë atë me kusht. Pranimi me kusht duhet të identifikojë veprimet e mbetura pezull, afatet dhe nëse pagesa mund të bëhet tërësisht, pjesërisht ose vetëm pas plotësimit të kushteve.

# 11. Kriteret Treguese të Pranimit

| Kriter | Kuptimi |
|---|---|
| **Plotësia** | Dokumenti i dorëzuar mbulon të gjitha temat e kërkuara në Termat e References, PMP dhe Fushën e Veprimit e miratuar. |
| **Saktësia** | Faktet, shifrat, llogaritjet, referencat ligjore, supozimet dhe terminologjia janë të sakta ose të kualifikuara qartë aty ku ekziston pasiguri. |
| **Gjurmueshmëria** | Të gjitha rekomandimet kryesore mund të gjurmohen në të dhëna, analiza, kontribute të palëve të interesuara, kërkesa ligjore, prova referuese ose vendime të BSZH-së. |
| **Mundësiae përdorimit** | Rezultati mund të përdoret nga BSZH pa ripërpunim të konsiderueshëm për qëllimin e saj të synuar të qeverisjes, operacional, të prokurimit, financiar ose të zbatimit. |
| **Mundësia e modifikimit** | Dokumentet ofrohen në formate të modifikueshme dhe nuk janë të bllokuara ose të kufizuara, përveç nëse BSZH kërkon ndryshe. |
| **Konsistenca** | Produkti është në përputhje me ligjin e BSZH-së, planin paraprak, zgjedhjet strategjike të miratuara, produktet e tjera dhe vendimet e mëparshme të BSZH-së. |
| **Orientimi i zbatimit** | Rekomandimet përfshijnë hapat e mëtejshëm për implementimin praktik, personat përgjegjës, varësitë në zbatim, afatet kohore, rreziqet dhe vendimet e kërkuara. |
| **Cilësia e hartimit** | Dokumentet janë të qarta, të shkruara profesionalisht, të formatuara në mënyrë të qëndrueshme dhe të përshtatshme për shqyrtim nga strukturat qeverisjes. |
| **Transferimi i njohurive** | Kur është e rëndësishme, produkti i dorëzuar përfshin udhëzime të plot për stafin e BSZH-së në kuadër të mirëmbajtes, përditësimit ose vënien në funksion të tij. |

| Kriter | Kuptimi |
|---|---|
| **Përputhshmëria** | Produkti respekton kriteret e konfidencialitetit, kufizimeve të prokurimit publik, detyrimev e ktëonfliktit të interesit, rregullave e trajtimit të të dhënave, dhe të gjitha standardet ligjore shqiptare dhe të BE-së/ndërkombëtare të rëndësishme për zhvillimin e detyrës. |

## 12. Menaxhimi i Projekteve, Raportimi dhe Struktura Qeverisëse

### 12.1 Organet dhe Rolet e Strukturave Qeverisëse

| Roli | Përgjegjësitë kryesore | Dokumentacioni i detyrueshëm |
|---|---|---|
| Menaxher i Ekzekutimit të Kontratave të BSZH-së | Administrimi i kontratave, koordinimi i verifikimit, certifikimi dhe likuidimi i faturave. | Dokumente miratimi, certifikata, korrespondencë, gjurmues komentesh. |
| Personat përgjegjës për linjën e punës (ëorkstream) së BSZH-së | Rishikimi teknik i rezultateve të linjës së punës dhe konfirmimi i mundësisë së përdorimit. | Komentet, Dokumentet e validimit, procesverbalet, rekomandimet për miratim. |
| Udhëheqësi Teknik i Kontraktorit | Përgjegjësi e përgjithshme për ofrimin, cilësinë, menaxhimin e burimeve dhe ndërveprimin me BSZH-në. | Deklaratat e sigurimit të cilësisë, PMP, RSP, dokumentet e zgjidhjes së problemeve me rëndësi |
| Menaxher Projekti Kontraktori / PMO | Koordinim i përditshëm, raportim, gjurmim, kontroll i orarit, menaxhim i problemeve. | RSP, Gantt, gjurmues veprimi, gjurmues i faktorëve që sjelli varësi në zbatim, regjistra të problemeve dhe risqeve. |
| Ekspertë të Specializuar | Kontribute teknike në strategji, financa, risk, çështje ligjore, TIK, produkte, burime njerëzore ose fusha të tjera pune. | Shënime të ekspertëve, dokumente pune, modele, materiale seminari. |

### 12.2 Kalendari i Raportimit

- Takim koordinues javor dhe për ndjekjen e veprimeve, përveç nëse BSZH-ja bie dakord për një frekuencë ndryshe.
- Raporti Mujor i Statusit të Progresit i dorëzuar deri në ditën e pestë (5) të punës të muajit pasardhës.
- Takim mujor për shqyrtimin e arritjeve, rreziqeve, çështjeve të ndryshme, vendimeve, rezultateve dhe shpërndarjen e burimeve.
- Përcjellja e menjëhershme e çdo problemi që mund të vonojë përmbylljen e një etape të rëndësihme ose mund të ndikojë në një produkt të çertifikuar brenda pesë (5) ditë pune.

- Grafiku Gantt dhe indeksi i rezultateve të përditësuara me çdo RSP mujore.

## 13. Kontrolli i Ndryshimit

Çdo ndryshim në Fushën e Veprimit, rezultate, përpjekje, afate, kritere pranimi ose momente pagese duhet të dokumentohet përmes një Kërkese për Ndryshim të miratuar nga BSZH para zbatimit. Ndryshimet e kërkuara për shkak të një gabimi, harrese, cilësie të pamjaftueshme ose vonese së Kontraktorit nuk do të kompensohen me shpërblim shtesë.

- Kërkesat për Ndryshim duhet të përshkruajnë arsyen e ndryshimit, produktet e prekura, ndikimin në kosto, ndikimin në afat, rreziqet dhe masat zbutëse.
- BSZH mund të kërkojë një PMP të përditësuar përpara se të miratojë një ndryshim.
- Asnjë udhëzim verbal nuk do të përbëjë një ndryshim formal, përveç nëse konfirmohet me shkrim nga BSZH.
- Kontraktori duhet të mbajë një regjistër ndryshimesh dhe ta përfshijë atë në çdo RSP.

## 14. Profilet Profesionale dhe Personeli Kryesor

Kontraktori duhet të vendosë ekip/e me staf të kualifikuar që pasqyrojnë natyrën dhe ekspertizën e nevojshme për secilin aktivitet nën secilën shtyllë, në përputhje me profilet profesionale të kërkuara në procedurën e prokurimit dhe ofertën teknike. Udhëheqësit Teknik duhet të sigurojnë koordinimin.

| Profili | Përvojë minimale | Përgjegjësitë kryesore | Dëshmi e Kërkuar |
|---|---|---|---|
| Partner / Udhëheqës Teknik | Të paktën 10 vjet përvojë profesionale, duke përfshirë të paktën 8 vjet në konsulencë për institucione financiare, banka zhvillimi, institucione financiare publike evropiane ose entitete të krahasueshme. | Koordinimi i përgjithshëm, cilësia e menaxhimit strategjik, menaxhimi i palëve të interesuara të kategorisë së lartë, miratimi i rezultateve para dorëzimit, angazhimi i burimeve. | CV, deklaratë disponueshmërie, deklaratë konflikti interesi, dëshmi të aftësive gjuhësore. |
| Menaxher i lartë/ Senior | Të paktën 6 vjet përvojë relevante në strategji, planifikim institucional/operacional, PMO, shërbime financiare, institucione të | Ofrimi i përditshëm, mbikëqyrja e linjës së punës, hartimi i materialeve komplekse të produkteve, zgjidhja e problemeve, | CV, referenca për detyrat, caktimi i planit të punës, prova të aftësive gjuhësore. |

| Profili | Përvojë minimale | Përgjegjësitë kryesore | Dëshmi e Kërkuar |
|---|---|---|---|
| | zhvillimit publik ose detyra të krahasueshme. | koordinimi me ekipet e BSZH-së. | |
| Junior/ Nivel fillestar | Të paktën 3 vjet përvojë profesionale nga diplomimi. | Hulumtim, dokumentim, analizë, procesverbale, gjurmim, përpunim të dhënash, mbështetje për rezultatet e punës. | CV, plan shpërndarjeje, angazhim për ruajtje konfidencialiteti. |

Zëvendësimet e personelit do të kërkojnë miratim paraprak me shkrim nga BSZH. Përfshirja e personelit zëvendësues do të bëhet me shpenzimet e Kontraktorit dhe nuk do të vonojë rezultatet.

## 15. Konfidencialiteti, Trajtimi i të Dhënave dhe Konflikti i Interesit

- Kontraktori duhet të përpunojë, ruajë dhe transmetojë informacionin e BSZH-së vetëm përmes metodave dhe mjeteve të miratuara nga BSZH-ja.
- Çdo paraqitje, transferim ose ruajtje e informacionit të BSZH jashtë kanaleve të miratuara do të kërkojë autorizim paraprak me shkrim dhe mjete të forta enkriptimi, duke përfshirë 3DES, AES ose masa mbrojtëse ekuivalente, në përputhje me Seksionin 18.7.
- I gjithë informacioni i projektit do të ruhet vetëm për periudhën e autorizuar nga BSZH dhe nëse kërkohet do të kthehet, fshihet ose shkatërrohet në mbylljen e projektit. Kjo veprimtari do të mbështetet nga një certifikatë me shkrim kthimi/fshirjeje/shkatërrimi, kur ajo kërkohet nga BSZH.
- Kontraktori nuk duhet ta përdorë angazhimin si referencë ose si reklamim për veprimtarinë e tij pa autorizimin paraprak me shkrim të BSZH-së.
- Kur Kontraktori përgatit materiale relevante për procedurat e ardhshme të prokurimit, ai duhet të përmbushë të gjitha kufizimet e konfliktit të interesit dhe përputhshmërisë, dhe mund të përjashtohet nga pjesëmarrja në tenderët përkatës të mëvonshëm, kur kërkohet nga ligji ose parimet e prokurimit.

## 16. Lidhja midis Certifikimit dhe Pagesës

Pagesat do të bëhen vetëm për produktet e pranuara, shtyllave ose fazave të projektit, siç specifikohet në PMP-në përkatëse. Lëshimi i një Certifikate të Performancës nga BSZH është parakusht për faturimin, përveç nëse Kontrata parashikon shprehimisht ndryshe.

- Nuk do të ketë pagesë për përgatitjen, ndryshimin ose ridërgimin e një PMP-je, përveç nëse përfshihet shprehimisht në një Urdhër Dorëzimi të miratuar.
- Nuk do të ketë pagesë për materiale të paplota, drafte të pambështetura ose rezultate që nuk mund të verifikohen për shkak se mungon Paketa e Kërkuar e Provave.
- Faturat duhet të përmendin Porosinë përkatëse të Dorëzimit, kodin e dorëzimit, numrin e certifikatës, shumën e miratuar dhe periudhën përkatëse të faturimit.

- BSZH mund të refuzojë faturat që nuk mbështeten nga provat faktike dhe certifikatat përkatëse.
- Pagesa e kostove të rimbursueshme do të kryhet jo më shpesh se çdo dy muaj, me paraqitjen e një kërkese të nënshkruar që detajon këto kosto të shoqëruara me faturat përkatëse (kur është e aplikueshme). Megjithatë, kostoja totale nuk duhet të kalojë shumën e përfshirë në ofertën ekonomike.

## 17. Dokumentacioni dhe Standardet e Formatimit

- Të gjitha draft-projektet e dorëzueshme do të ofrohen në anglisht. Dokumentacioni përfundimtar do të ofrohet në anglisht dhe shqip.
- Dokumentet për miratimin nga strukturat e qeverisjes duhet të ofrohen në formate Word dhe PoëerPoint të modifikueshme dhe, kur është e nevojshme, në PDF.
- Modelet financiare duhet të ofrohen në Excel me formula transparente, fletë supozimesh, historik versionesh dhe qeliza të kyçura vetëm aty ku është rënë dakord me BSZH-në.
- Dokumentet qe identifikojnë vijueshmërinë e procesit duhet të ofrohen në formate të modifikueshme, të dakorduara me BSZH-në, dhe si PDF për shqyrtim.
- Të gjitha produktet duhet të përdorin kode, numra versionesh, data, autorësi dhe emërtime të tilla si Draft, Draft i Rishikuar, Përfundimtar për Miratim dhe Përfundimisht i Pranuar.
- Kontraktori duhet të mbajë një Indeks të plotë të Produkteve të Dorëzuara dhe ta përditësojë atë çdo muaj.

## 18. Dispozita shtesë kontraktuale dhe operative

Dispozitat e mëposhtme plotësojnë dhe formojnë një pjesë integrale të Termave të Referencës. Në rast mbivendosjeje, ato do të lexohen së bashku me dispozitat specifike të dorëzimit, pranimit, PMP-së, pagesës dhe certifikimit të përcaktuara më sipër, përveç nëse Kontrata parashikon shprehimisht ndryshe.

### 18.1 Kufiri Financiar, Tarifat Njësi dhe Mekanika e Shpërblimit

Vlera totale e shërbimeve do t'i nënshtrohet kufirit financiar/shpenzimeve të përcaktuara në Kontratë dhe në dokumentet përfundimtare të tenderit. Kufiri financiar nuk do të tejkalohet pa miratimin paraprak me shkrim të BSZH-së dhe ndryshimin formal të Kontratës, kur kjo kërkohet në përputhje me legjislacionin vendas.

Shpërblimi i Kontraktorit do të llogaritet duke iu referuar tarifave ditore për njësi të dhëna për profilet profesionale të bazuara në rolin e ekspertëve që angazhohen, përkatësisht Partner, Menaxher/Senior dhe Junior/Nivel Fillestar. Tarifat e zbatueshme do të jenë ato që rezultojnë nga procedura e tenderit, pas zbatimit të zbritjes së ofruar nga Kontraktori, dhe do të jenë pa TVSH, përveç nëse përcaktohet ndryshe në Kontratë.

Shërbimet duhet të planifikohen dhe të llogariten përmes Planeve të Menaxhimit të Projektit dhe Urdhrave të Dorëzimit të miratuara. Gjatë fazës së përcaktimit të PMP-së, Kontraktori duhet të vlerësojë përpjekjen e kërkuar në bazë të kohës dhe materialeve sipas profilit profesional; megjithatë, pasi të miratohen PMP-ja dhe Urdhri i Dorëzimit, do të zbatohen rregullat e shpërblimit të përcaktuara në Seksionin 18.2.

- PMP-ja duhet të identifikojë ditët e punës të vlerësuara sipas profilit, tarifat ditore të zbatueshme, vlerën që rezulton nga ndërhyrja dhe planin e faturimit.
- Të gjitha kostot e rastësishme, kostot e koordinimit, kostot e sigurimit të brendshëm të cilësisë, shpenzimet e përgjithshme dhe shpenzimet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve do të konsiderohen të përfshira në çmimet e dhëna, përveç nëse Kontrata parashikon shprehimisht ndryshe.

Kontraktori nuk ka të drejtë të kërkojë apo të përfitojë asnjë pagesë që tejkalon vlerën e miratuar në PMP/Porosinë e Dorëzimit, kufirin kontraktor të shpenzimeve ose shumën e certifikuar nga BSZH-ja.

### 18.2 PMP e Miratuar, Urdhri i Dorëzimit dhe Shpërblimi Fiks për Çdo Ndërhyrje

Për çdo ndërhyrje në projekt, PMP-ja dhe Urdhri i Dorëzimit i miratuar duhet të përcaktojnë Fushën e Veprimit, rezultatet e dorëzimit, afatet, kriteret e pranimit, burimet, ditët e punës të vlerësuara, vlerën ekonomike dhe planin e faturimit të ndërhyrjes.

Pasi të miratohen PMP dhe Urdhri i Dorëzimit, madhësia dhe vlera ekonomike e ndërhyrjes, për qëllime certifikimi dhe pagese, do të konsiderohe të eiksuara. Në varësi të pranimit dhe lëshimit të Certifikatës së Performancës, shuma që i njihet Kontraktorit do të jetë shuma e llogaritur në PMP/Urdhrin e Dorëzimit të miratuar, pavarësisht nga numri aktual i ditëve të punës të Kontraktorit.

Çdo ndryshim në angazhim, rezultatt, afate, burime ose vlerë ekonomike do të kërkojë një kërkesë paraprake me shkrim për ndryshim dhe miratimin e BSZH-së para zbatimit të saj. Burime shtesë ose të ndryshme mund të përdoren nga Kontraktori për qëllime të koordimit të brendshëm, por ato nuk do të rrisin shumën që do të paguhet, përveç nëse miratohen shprehimisht nga BSZH përmes një PMP / Urdhri Dorëzimi të ndryshuar.

### 18.3 Rregulli për përgatitjen e PMP-së pa kosto dhe iniciativat e e parealizuara

Të gjitha aktivitetet e nevojshme për mbledhjen e informacionit, përgatitjen, diskutimin, rishikimin, dorëzimin dhe pranimin e një PMP do të përballohen ekskluzivisht nga Kontraktori dhe nuk do të krijojnë ndonjë angazhim financiar për BSZH-në, përveç nëse aktivitete të tilla përfshihen shprehimisht në një Urdhër Dorëzimi të miratuar.

Kur BSZH nuk miraton një PMP të propozuar, ose kur iniciativa përkatëse braktiset para miratimit të PMP-së dhe Urdhrit të Dorëzimit, Kontraktorit nuk i lind e drejta për asnjë shpërblim për përgatitjen, rishikimin, diskutimin ose ri-dorëzimin e PMP-së ose materialeve të planifikimit.

### 18.4 Pezullimi, Anulimi dhe Shpërblimi i Përllogaritur

Nëse një iniciativë anulohet nga BSZH pas miratimit të PMP-së përkatëse dhe Urdhrit të Dorëzimit për arsye që nuk i atribuohen Kontraktorit, Kontraktori mund të ketë të drejtë për shpërblim deri në datën e njoftimit me shkrim të anulimit nga BSZH, me kusht që shpërblimi të mbështetet siç në prova të mjaftueshme dhe të pranohet nga BSZH.

Për këtë qëllim, provat e mjaftueshme duhet të përfshijnë, sipas rastit, Raportet e Statusit të Progresit të miratuara, draftet e produkteve të prodhuara deri në datën e anulimit, angazhimi kohor dhepërmbledhjea e përpjekjeve sipas profilit, procesverbalet e mbledhjeve, regjistrat e

veprimeve, versionet e dokumenteve dhe çdo material tjetër të kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga BSZH për të verifikuar punën efektivisht të kryer.

Nuk do të ketë kompensim nëse anulimi, pezullimi, refuzimi ose mungesa e certifikimit shkaktohet nga vonesa e Kontraktorit, mospërmbushja e detyrave, cilësia e pamjaftueshme, konflikti i interesit, shkelja e konfidencialitetit, burimet e pamjaftueshme ose mosrespektimi i Termave të Referencës, PMP-së, Urdhrit të Dorëzimit ose Kontratës.

### 18.5 Jo-ekskluziviteti dhe e drejta e BSZH-së për të angazhuar palë të treta

Marrëdhënia midis ADB dhe Kontraktorit nuk do të jetë ekskluzive. BSZH rezervon të drejtën që gjatë ekzekutimit të Kontratës, sipas gjykimit të saj të vetëm dhe pa krijuar ngritjen e ndonjë pretendimi nga Kontraktori, për të angazhuar konsulentë, ekspertë, këshilltarë të tjerë, institucione publike, partnerë ndërkombëtarë, ofrues të asistencës teknike, partnerë zbatimi, kontraktorë ose palë të treta.

BSZH mund të angazhojë gjithashtu palë të treta për të mbështetur aktivitetet që bien brenda fushave të përgjegjësisë së BSZH-së ose për të ofruar kontribute, shqyrtim, validim, mbështetje për zbatimin, opinione teknike ose koordinim institucional. Kontraktori duhet të bashkëpunojë me këto palë të treta, të shmangipunësn e dyfishtë, të ndajë informacion përmes kanaleve të miratuara nga BSZH dhe të sigurojë që rezultatet e veprimtarisë së tij të jenë në përputhje me udhëzimet e BSZH-së dhe PMP-në e miratuar.

### 18.6 Konflikti i interesit, papajtueshmëria për prokurimet e më pasme, publiciteti dhe angazhimet e ngjashme

Kontraktorit mund t'i kërkohet të hartojë ose mbështesë përgatitjen e materialeve relevante për procedurat e ardhshme të prokurimit publik, duke përfshirë specifikimet teknike, kërkesat, të dhënat e vlerësimit, planet e zbatimit, dokumentacionin që lidhet me prokurimin ose materiale të tjera që mund të ndikojnë në tendera pasues.

Kur Kontraktori ka përgatitur, shqyrtuar, ndikuar ose ka pasur akses të privilegjuar në materiale të tilla, pjesëmarrja e tij në vijim në procedurat përkatëse të prokurimit mund të kufizohet ose ndalohet, në përputhje me ligjin në fuqi, parimet e prokurimit dhe rregullat e konfliktit të interesit.

Kontraktori nuk do ta përdorë këtë angazhim, Kontratën, emrin e BSZH-së, materialet e BSZH-së ose ndonjë referencë ndaj detyrës për publicitet, marketing, kredenciale, njoftime për shtyp, referenca për klientët, propozime ose qëllime të tjera të ngjashme e pa autorizimin paraprak me shkrim të BSZH-së.

Kontraktori duhet të njoftojë BSZH-në me shkrim përpara se të ndërmarrë ndonjë detyrë të lidhur, të varur ose potencialisht në konflikt me angazhimin aktual. Kur BSZH-ja konsideron se detyra e lidhur mund të shkaktojë konflikt interesi, akses të privilegjuar, papajtueshmëri, rrezik konfidencialiteti ose shqetësim për reputacionin, mund të kërkojë masa zbutëse ose të mos shprehë kundërshtim.

### 18.7 Certifikimi i Bazës së Ruajtjes së të Dhënave, Enkriptimit, Ruajtjes dhe Fshirjes së të Dhënave

Kontraktori është i detyruar të përpunojë, ruajë dhe administrojë të gjitha të dhënat, informacionet, dosjet e punës, draftet, dokumentet dhe materialet e marra ose të prodhuara gjatë zbatimit të Kontratës, vetëm nëpërmjet metodave, hapësirave të ruajtjes, dosjeve në rrjet, platformave, arkivave ose mjeteve të tjera të vëna në dispozicion ose të miratuara shprehimisht nga BSZH-ja.

Çdo përdorim, transmetim, paraqitje ose ruajtje e informacionit të BSZH-së jashtë kanaleve të miratuara do të kërkojë autorizim paraprak me shkrim nga BSZH. Kur jepet një autorizim i tillë, Kontraktori duhet të aplikojë mjete të forta enkriptimi, duke përfshirë 3DES, AES ose mbrojtje ekuivalente, dhe duhet të sigurojë që të gjitha pajisjet, mjetet dhe masat e sigurisë të kërkuara të ofrohen me shpenzimet e veta.

Kontraktori do të ruajë informacionin e BSZH-së vetëm për periudhën e autorizuar nga BSZH-ja dhe, përveç nëse udhëzohet ndryshe me shkrim, vetëm deri në mbylljen e projektit. Me kërkesë të BSZH-së dhe në çdo rast në mbylljen e projektit, Kontraktori do të kthejë, fshijë ose shkatërrojë informacionin e BSZH-së dhe do të ofrojë një certifikatë me shkrim kthimi/fshirjeje/shkatërrimi që konfirmon masat e marra, fushëveprimin e informacionit të mbuluar dhe çdo përjashtim të kërkuar me ligj.

- Të gjitha dokumentet elektronike, mediat e jashtme dhe dokumentet e transmetuara duhet të jenë të lira nga viruset, programet keqdashëse, kodet keqdashëse dhe përmbajtjet e korruptuara. BSZH mund të verifikojë materialet e paraqitura duke përdorur mjetet dhe metodat e zgjedhura prej saj.
- Kontraktori duhet të ketë masa të mjaftueshme sigurie, konfidencialiteti dhe kontrolli të aksesit gjatë gjithë detyrës dhe duhet të raportojë menjëherë çdo humbje të dyshuar, akses të paautorizuar, zbulim ose incident sigurie që ndikon në informacionin e BSZH-së.

### 18.8 Miratimi i Personelit, Ekipet e Dedikuara, Rregullat e Zëvendësimit dhe Kërkesat Gjuhësore

Kontraktori duhet të përdorë personelin e paraqitur për angazhim në ofertën e tij teknike, përveç nëse zëvendësimi miratohet paraprakisht nga BSZH. BSZH mund të kryejë intervista, kontrolle kompetence dhe vlerësime të përshtatshmërisë të çdo anëtar të personelit të propozuar dhe mund të refuzojë ose të kërkojë zëvendësimin e subjekteve të konsideruar si të papërshtatsëm për detyrën ose për një veprimtari specifike.

Kontraktori duhet të sigurojë që ekipet e caktuara për Shtyllën 1 dhe Shtyllën 2 të përbëhen nga anëtarë të ekipit të cilët reflektojnë natyrën, ekspertizën dhe përgjegjësitë e ndryshme të kërkuara, duke ruajtur koordinimin përmes marrëveshjeve të Udhëheqësit Teknik dhe PMO-së.

Çdo zëvendësim personeli do të kërkojë autorizim paraprak me shkrim nga BSZH-ja. Kontraktori duhet të sigurojë që personelit të ri ti dorëzohet dhe jepen njohuritë e mjaftueshme mbi ecurinë e projektit. Të gjitha kostot e zëvendësimit, marrjes në dorëzim dhe integrimit do të mbulohen

ekskluzivisht nga Kontraktori dhe nuk do të vonojnë asnjë produkt, etap të rëndësishme, proces shqyrtimi ose aktivitet certifikimi.

BSZH mund të refuzojë çdo zëvendësim që nuk përmbush kriteret e vjetërsi, ekspertizës, disponueshmërisë dhe vazhdimësisë.

- I gjithë personeli kyç duhet të ketë njohuri profesionale të gjuhës angleze, me aftësi jo më të ulët se C1 për komunikim dhe shkrim.

### 18.9 Periudha Fillestare e Angazhimit dhe Mobilizimit

Pas njoftimit të fituesit përfundimtar dhe/ose nënshkrimit të Kontratës, BSZH-ja mund të lejojë ose të kërkojë një periudhë fillestare të marrjes në dorëzim dhe mobilizimit, me qëllim përvetësimin e njohurive, integrimin fillestar, konfigurimin e aksesit dhe njohjen me dokumentacionin e BSZH-së, si dhe me rregullimet institucionale përkatëse.

Data efektive e fillimit dhe rregullimet e hollësishme të kësaj periudhe do të komunikohen ose miratohen nga BSZH. Kohëzgjatja maksimale e periudhës fillestare të marrjes në dorëzim do të jetë një (1) muaj, përveç nëse është rënë dakord ndryshe me shkrim nga BSZH.

Nuk do të ketë kompensim për trajnimin, njohjen, integrimin e brendshëm ose aktivitetet e fitimit të njohurive të kryera gjatë periudhës fillestare, përveç nëse përfshihen shprehimisht në një Urdhër Dorëzimi të miratuar. Aktivitete të tilla nuk do të vonojnë fillimin, ekzekutimin ose përfundimin e ndonjë ndërhyrjeje, produkti ose etape të rëndësishme të kërkuar nga BSZH.

### 18.10 Transferimi dhe Dorëzimi i Njohurive

Kontraktori është i detyruar që, gjatë ofrimit të shërbimeve dhe në mbyllje të projektit, të realizojë transferimin efektiv të njohurive te personeli i BSZH-së ose te palët e treta të caktuara nga BSZH-ja, për të gjitha aktivitetet e kryera, metodologjitë e përdorura, modelet e zhvilluara, supozimet e aplikuara, proceset e hartuara dhe dokumentet e prodhuara në kuadër të Kontratës.

Transferimi i njohurive mund të përfshijë seanca përmbledhëse, seanca të përbashkëta pune, punëtori, prezantime, tryeza teknike, demonstrime të modeleve dhe hartave të proceseve, seanca pyetje-përgjigje, takime dorëzimi, si dhe formate të tjera të dakordësuara me BSZH-në

Dokumentimi i transferimit të njohurive duhet të mbështetet, sipas rastit, në materiale trajnimi, lista pjesëmarrjeje, rende dite, procesverbale, dokumente dorëzimi, regjistrime kur lejohen, regjistra pyetje-përgjigjesh, dokumente model, udhëzues përdorimi dhe konfirmimin përfundimtar të dorëzimit.

### 18.11 Vendi i punës, aksesi dhe orari i punës

BSZH mund të vërë në dispozicion zyrat e saj për të pritur personelin e Kontraktorit për kryerjen e shërbimeve. Përveç nëse është rënë dakord ndryshe në PMP ose nga BSZH, shërbimet për çdo

ndërhyrjeje të bazuar në projekt normalisht do të kryhen në ambientet e BSZH ose përmes modaliteteve të tjera të punës të miratuara nga BSZH.

BSZH do të vërë në dispozicion, kur është e nevojshme dhe në përputhje me rregullat e saj të brendshme, hapësira pune të përshtatshme dhe të drejta aksesi në IT për t'i mundësuar personelit të Kontraktorit kryerjen e shërbimeve të kërkuara. Të drejtat e aksesit do të përdoren vetëm për qëllimet e Kontratës dhe në përputhje me politikat e BSZH-së.

Orari normal i zyrës së BSZH-së pritet të jetë nga ora 9:00 e mëngjesit deri në orën 17:00 në ditët e punës, përveç nëse BSZH komunikon rregullime të ndryshme. BSZH rezervon të drejtën për të ndryshuar orarin e zyrës, rregullimet e aksesit, procedurat e sigurisë ose modalitetet e punës në distancë me njoftim paraprak.

### 18.12 Dokumentacioni, Dorëzimi Formal dhe E Drejta e BSZH-së për të Modifikuar Formatet

I gjithë dokumentacioni i prodhuar gjatë kryerjes së shërbimeve duhet të jetë i pajtueshëm me formatet MS Word, MS Excel, MS PoëerPoint, Acrobat/PDF dhe çdo mjet ose format tjetër të komunikuar ose të miratuar nga BSZH. Përdorimi i mjeteve të tjera do t'i nënshtrohet marrëveshjes paraprake me BSZH-në.

BSZH rezervon të drejtën për të modifikuar, plotësuar ose zëvendësuar mjetet e dokumentimit, modelet e dokumenteve tip, emërtimet e dokumenteve, formatet PMP, formatet e raportimit, formatet e dorëzimit, modelet e e paketave të provave dhe kërkesat e tjera për dokumentimin gjatë ofrimit të shërbimit, në varësi të një njoftimi paraprak të arsyeshëm.

Çdo produkt i dorëzueshëm duhet të dorëzohet në format elektronik të printueshëm, si dhe në format elektronik të modifikueshëm, sipas aplikacionit ose mjetit me të cilin është përgatitur. Dorëzimi nuk konsiderohet i kryer formalisht nëse produkti nuk shoqërohet me shkresë dorëzimi ose me një akt tjetër zyrtar përcjelljeje, që identifikon qartë kodin e produktit, titullin, versionin, datën, skedarët e dorëzuar dhe veprimin që kërkohet nga BSZH-ja.

### 18.13 Pezullimi i Periudhës së Miratimit për Shkak të Problematikave të Rënda

Kur një produkt i dorëzuar ose një Paketë Provash përmban anomali, harresa, mospërputhje, dokumenta të korruptuar, dokumente që mungojnë, supozime të pambështetura, dokumente pune të paplotë ose mangësi të tjera të një shkalle të tillë që BSZH nuk mund të kryejë në mënyrë të arsyeshme aktivitetet e saj të verifikimit, periudha përkatëse e shqyrtimit ose miratimit pezullohet.

Në raste të tilla, periudha e shqyrtimit ose miratimit do të rifillojë nga e para vetëm pas dorëzimit nga Kontraktori të një produkti të plotë dhe të rishikuar që i mundëson BSZH-së të kryejë aktivitetet përkatëse të verifikimit. Kontraktori nuk do të ketë të drejtë për ndonjë shpërblim shtesë ose zgjatje kohore të shkaktuar nga mangësi të tilla, përveç nëse BSZH e përcakton shprehimisht ndryshe me shkrim.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur identifikohen mangësi të rënda pas kontrollit fillestar të plotësisë gjatë shqyrtimit thelbësor.

## 19. Shtojca A – Lista e Kontrollit të Paketës Standarde të Provave

| Jo. | Provë | U dorëzua? | Shënime të BSZH-së |
|---|---|---|---|
| 1 | Letër dërgimi | Po / Jo / Jo | |
| 2 | Dokument i modifikueshëm | Po / Jo / Jo | |
| 3 | Versioni PDF, aty ku është e rëndësishme | Po / Jo / Jo | |
| 4 | Lista e kontrollit të përputhshmërisë me rregullat e përputhshmërise | Po / Jo / Jo | |
| 5 | Matrica e zgjidhjes së komenteve | Po / Jo / Jo | |
| 6 | Regjistri i supozimeve dhe burimeve | Po / Jo / Jo | |
| 7 | Ekstrakt i regjistrit të vendimeve | Po / Jo / Jo | |
| 8 | Procesverbali i takimit/punës | Po / Jo / Jo | |
| 9 | Dokument për pjesëmarrjen, aty ku është e nevojshme | Po / Jo / Jo | |
| 10 | Modeli/ dokumentet e punës | Po / Jo / Jo | |
| 11 | Deklaratë për sigurimin e cilësisë | Po / Jo / Jo | |
| 12 | Regjistri i hapur i problemeve dhe varësive | Po / Jo / Jo | |
| 13 | Formulari i kërkesës për certifikatë | Po / Jo / Jo | |

## 20. Shtojca B – Modeli i Certifikatës së Performancës

Nr. i Certifikatës: [●]

Porosia e Dorëzimit / Kodi i Projektit: [●]

Produkti/Produktet: [●]

Kontraktori: [●]

Data e hyrjes në fuqi të kontratës: [●]

Deklarata e Certifikimit: Bazuar në shqyrtimin e produktit/produkteve, Pakos së Dëshmive përkatëse dhe aktiviteteve të verifikimit të kryera nga BSZH, Menaxheri i Ekzekutimit të Kontratës konfirmon se produkti/produktet e listuara më sipër janë kryer dhe pranuar siç duhet në përputhje me Kontratën, Termat e Referencës dhe PMP-në e miratuar, në varësi të kualifikimeve të mëposhtme, nëse ka: [●].

Kushtet Përjashtuese, nëse ka: [●]

Shuma e pranueshme për faturim: [●]

Data: [●]

Menaxheri i Ekzekutimit të Kontratave të BSZH-së: ___________________________

Personi/Personat përgjegjës(ët) i linjës së punës së BSZH-së, kur është e aplikueshme:

___________________________

## 21. Shtojca C – Struktura Minimale e Planit të Menaxhimit të Projektit

1. Kodi, emri dhe përshkrimi i projektit
2. Njësitë e BSZH-së dhe palët e jashtme të përfshira
3. Fusha e Veprimit dhe rezultatet
4. Aktivitete të detajuara me datat e fillimit dhe mbarimit
5. Grafiku Gantt dhe varësitë për zbatimin
6. Burimet, rolet dhe ditët e punës të vlerësuara
7. Matrica RACI
8. Kriteret e pranimit dhe kërkesat për prova
9. Frekuenca e raportimit dhe kalendari i takimeve
10. Rreziqet, problemet, supozimet dhe kufizimet
11. Marrëveshjet për kontroll/ ndryshim
12. Vlera ekonomike dhe plani i faturimit
13. Autoritetet për miratimin dhe afatet e shqyrtimit

## 22. Shtojca D – Struktura e Raportit Mujor të Statusit të Progresit

1. Periudha referuese dhe data e raportimit
2. Përmbledhje ekzekutive
3. Progresi kundër PMP dhe Gantt
4. Produktet e dorëzuara, në shqyrtim, të miratuara dhe të vonuara
5. Datat aktuale të fillimit/përfundimit të aktiviteteve
6. Burimet e vendosura dhe përmbledhja e përpjekjeve
7. Çështjet, risqet, varësitë për zbatimin dhe masat zbutëse
8. Vendimet e kërkuara nga BSZH
9. Kërkesat për ndryshim, të ngritura ose të miratuara
10. Planifikimi për periudhën e ardhshme të raportimit
11. Indeksi i rezultateve të përditësuara
12. Gjurmues veprimesh, regjistër problemesh, regjistër rreziku dhe regjistër vendimesh i përditësuar

## 23. Shtojca E – Shtylla 2 e Detajuar dhe Treguese

Shtylla 2 do të përfshijë, *ndër të tjera* , **aktivitetet e mëposhtme** :

**<u>Ndërfunksionaliteti:</u>**

1. **Aktivitetet e PMO-së dhe koordinim i ekipit**: Koordinimi i ekipeve të brendshme, ekipeve të konsulentëve dhe grupeve të punës, përmes hartimit të një plani të integruar pune që përcakton momentet kryesore për secilin grup pune, identifikimit të varësive të zbatimit ndërmjet tyre, menaxhimit të komunikimit ndërmjet ekipeve, koordinimit të burimeve, planifikimit të aktiviteteve, monitorimit të progresit kundrejt afateve dhe momenteve

kryesore, ndjekjes së KPI-ve, zgjidhjes së çështjeve operacionale dhe identifikimit e adresimit të problematikave në iniciativa specifike.

2. **Përfshirja e ekspertëve dhe strukturave të specializuara të ekspertizës:** angazhimi i ekspertëve vendas dhe/ose ndërkombëtarë, si dhe i strukturave të specializuara të ekspertizës me njohuri të thelluara në fusha të caktuara me rëndësi për projektin, për të mbështetur, validuar dhe rishikuar analizat e kryera nga grupet e punës**.**
3. **Hartimi i dokumenteve, raporteve dhe zbatimi i proceseve** : Përgatitja e dokumenteve dhe raporteve që shërbejnë për përshkrimin e zgjidhjeve të propozuara dhe për komunikimin e progresit të aktiviteteve me palët e brendshme dhe të jashtme të interesit, në shqip ose anglisht, në varësi të qëllimit të dokumentit dhe kërkesave përkatëse.

**Strategjia dhe Misioni:**

4. **Analiza e Standardeve** : Analiza dhe krahasimi i Institucioneve të ngjashme Kombëtare të Promovimit me qëllim identifikimin e modelit më efektiv dhe të përshtatshëm të operimit për kontekstin shqiptar.
5. **Përkufizimi i kontekstit:** detajimi i linjës së investimeve strategjike në infrastrukturë për qeverinë shqiptare dhe potenciali i kreditimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të cilat do të trajtohen nga NPI-ja. Vlerësimi i kontekstit ekonomik dhe social shqiptar në kuadër të identifikimit të levave të financimit.
6. **Miratimi strategjik i modelit paraprak të funksionimit të NPI-së** : Analiza dhe miratimi i modelit të NPI-së të përcaktuar më sipër.

**Ligjore dhe Qeverisje:**

7. **Përputhja me kërkesat e ligjore** : Sigurimi që kërkesat ligjore të përmbushen nga NPI-ja, në mënyrë të tillë që të garantohet përputshmëria me ligjin kombëtar/ndërkombëtar nëpërmjet zbatimit të kuadrit të duhur rregullator për përputhshmëri dhe bashkëpunim institucional.

**Financimi dhe Financat:**

8. **Madhësia e financimit:** Pas përcaktimit të linjave prioritare të ndërhyrjes në ekonomi dhe përcaktimit sasior të investimeve, në bazë të linjës së përcaktuar më parë, do të jetë e nevojshme të identifikohen burimet e financimit dhe garancitë e nevojshme për të zbatuar iniciativat përkatëse.
9. **Kursimi Postar** :
    a. Identifikimi i produkteve të kursimit me pakicë të cilat janë në përputhje me kontekstin socio-ekonomik dhe të nevojshme për mbështetjen e vijimit të iniciativave.
    b. Ngritja e modelit të shpërndarjes (struktura e propozuar: NPI është emëtuesi, dhe Posta Shqiptare është shpërndarësi si i produkteve të kursimit ashtu edhe i kartave të pagesës (të dëshiruara) që lidhen me to);
    c. Përgatitja e modelit të biznesit në të cilin të përcaktohet masa e shpërblimit të Postës Shqiptare dhe lista e operacioneve e nevojshme për të aktivizuar shpërndarjen.

d. Projekt-akt që rregullon vendosjen e produkteve të kursimit postar.

e. Përcaktimi i strukturës organizative dhe teknologjike të proceseve operative, të kontrollit dhe të veprimtarisë të Postës Shqiptare për vendosjen dhe menaxhimin e produkteve/shërbimeve të kursimit dhe pagesave.

10. **Mbledhja dhe kapitalizimi financiar** : Përzgjedhja e mekanizmave të financimit dhe kapitalizimit të Institucionit, bazuar në kontekstin e analizuar më parë.

11. **Analiza e organizimit të thesarit:** Përcaktimi i kuadrit gjithëpërfshirës rregullator të bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë, Postën Shqiptare, duke përfshirë hapjen e: (i) një llogarie thesari; (ii) një llogarie letrash me vlerë; dhe (iii) një llogarie në Bankën e Shqipërisë në mënyrë që të lejohet pjesëmarrja në operacionet e tregut të Bankës Qendrore. Mbështetja në përcaktimin e kritereve të shpërblimit për llogarië e thesarit që mbartin interesa.

**<u>Oferta e produkteve:</u>**

12. **Përkufizimi i produktit** : Përcaktimi dhe shqyrtimi i tregut të synuar për produktet e ofruara, miratimi i modelit të shërbimit dhe zhvillimi i një plani pune. Për dy linjat kryesore të biznesit të identifikuara për Fazën 2 të zhvillimit institucional:

    i) Për segmentin e NVM-ve dhe korporatave, të vlerësohet dhe miratohet modeli aktual në raport me nevojat financiare të NVM-ve, korporatave dhe madhësinë e tregut; të konsolidohet oferta e produkteve, përmes identifikimit të llojit më të përshtatshëm të garancisë, duke marrë në konsideratë nevojat e tregut dhe burimet e disponueshme; të zhvillohet procesi i bashkëpunimit me bankat tregtare, me qëllim përsosjen e modelit të plotësueshmërisë së NPI-së, bazuar në instrumentet e garancisë për Fazën 2; si dhe të përcaktohet procesi kalimtar që do t'i mundësojë NPI-së të kalojë nga kjo fazë në Fazën 3, ku parashikohet fillimi i huadhënies së drejtpërdrejtë për ndërmarrjet/NVM-të.

    ii) Për huadhënien e drejtpërdrejtë për projekte strategjike, përfshirë, ndër të tjera, projektet në infrastrukturë, të cilat parashikohet të bëhen operative në Fazën 2, të identifikohet tregu i synuar dhe nevojat për financim; të zhvillohet një plan biznesi për këtë linjë veprimtarie; si dhe të identifikohen lehtësirat dhe burimet e mundshme të financimit, përfshirë ato nga Bashkimi Evropian, institucionet financiare ndërkombëtare dhe burime të tjera të përshtatshme, që mund të përdoren për financimin e projekteve përkatëse.

**<u>Rreziku dhe Mbikëqyrja:</u>**

13. **13. Zbutja e riskut:** Përcaktimi, rishikimi, miratimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i një kuadri të thjeshtë dhe praktik për administrimin e riskut, i cili adreson kategoritë kryesore të riskut të lidhura me veprimtarinë dhe operacionet kryesore të BSZH-së, përfshirë riskun e kredisë, riskun e likuiditetit, riskun e normës së interesit dhe risqe të tjera përkatëse. Ky kuadër duhet të përfshijë një Politikë Risku që përcakton parimet kryesore, rregullat, përgjegjësitë, pragjet

dhe mekanizmat e raportimit, si dhe një set mjetesh dhe matricash bazë për vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e riskut.

14. **Mbikëqyrja e autoritetit** : Mbështetja e grupit të punës shqiptar në bashkëpunimin me Bankën Qendrore të Shqipërisë dhe autoritetet ndërkombëtare në identifikimin e mekanizmave të mbikëqyrjes të cilat janë më të përshtatshëm për këtë qëllim, në përputhje me standardet dhe udhëzimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

**TIK dhe Operacione:**

15. **Përkufizimi i Strategjisë së TIK-ut dhe Oreksit të Riskut**: Vlerësimi i proceseve, funksioneve dhe pajisjeve që duhet të administrohen brenda BSZH-së, si dhe i atyre që mund të sigurohen përmes outsourcing/shërbimeve të jashtme, duke marrë në konsideratë risqet përkatëse, kërkesat operacionale dhe mundësitë e tregut.
16. **Përkufizimi i burimeve të nevojshme:** Përcaktimi i burimetve e nevojshme për përfundimin e projektin, duke përfshirë mjetet softuerike, qasjen në të dhënat e biznesit, etj.
17. **Projektimi i modelit operativ dhe optimizimi i procesit**: Thellimi dhe detajimi i makro-proceseve të modelit operativ të identifikuara më parë në Planin e nivelit të lartë, duke përcaktuar përgjegjësitë, llogaridhëniet, barrën dhe detyrat e secilës palë të interesuar në secilën fazë të procesit. Kjo mund të përfshijë zhvillimin e procedurave standarde të operimit.

**Burimet Njerëzore dhe Organizimi:**

18. **Strukturimi i skemës organizative** : Miratimi i skemës organizative (duke përfshirë përcaktimin e madhësisë së Bankës në fazën 1) dhe mbështetja e Burimeve Njerëzore në përcaktimin e aftësive të punonjësve që do të rekrutohen dhe procesin e integrimit të tyre.
19. **Dizajni i proceseve kryesore** : Identifikimi në procese "të domosdoshme" / "prioritet-1" të BSZH, duke ofruar një dizajn të cilësisë së lartë.

### Koordinimi midis shtyllave

Rezultatet e prodhuara sipas Shtyllës 1 – Këshillimi Strategjik do të përbëjnë **udhëzuesin për kornizës strategjike për aktivitetet e përcaktuara** nën Shtyllën 2 – Zbatimi dhe Mbështetja e PMO-së.

Kontraktori duhet të sigurojë harmonizimin e vazhdueshëm ndërmjet Shtyllës 1 dhe Shtyllës 2, si dhe të mbështesë BSZH-në në përkthimin e vendimeve strategjike në veprime konkrete operacionale

**Shtojca 7.**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet:** "Shërbime konsulence për mbështetjen e zhvillimit të kuadrit strategjik dhe operacional të BZH (ADB) – Banka Shqiptare e Zhvillimit".

**Afatet e ekzekutimit:**

| Nr. | Përshkrimi i shërbimit | Periudha totale në muaj | Vendi i ekzekutimit | Afati i ekzekutimit |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Shërbime konsulence për mbështetjen e zhvillimit të kuadrit strategjik dhe operacional të BZH (ADB) – Banka Shqiptare e Zhvillimit | Shtylla e parë – muaj<br>Shtylla e dytë – muaj<br>Periudha totale- muaj | Në përputhje me Specifikimet Teknike. | Në përputhje me Specifikimet Teknike. |

**Shtojca 8.**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:** Sipas Specifikimeve Teknike

**Detyrat:** Sipas Specifikimeve Teknike

**Shpërndarja:** Sipas Specifikimeve Teknike

**Vendi i kryerjes së shërbimeve:** Sipas Specifikimeve Teknike

**Shtojca 9**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

1. **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit,* ***sipas Shtojcës 10.***

*b. Sigurimin e Ofertës,* ***sipas Shtojcës 3****;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetin financiar dhe ekonomik, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron e tyre vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2023–2024–2025). Vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku të paktën dy prej tyre duhet të shoqërohen me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### 2.3.1. Përvojë e Mëparshme e Ngjashme

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.**

Operatori ekonomik mund të dëshmojë përmbushjen e kërkesës për shërbime të mëparshme të ngjashme përmes shërbimeve të realizuara nga vetë Ofertuesi ose nga grupi, rrjeti, partneriteti, organizata apo entitete të lidhura pjesë e të cilave ai bën pjesë, me kusht që Ofertuesi të provojë disponueshmërinë efektive të burimeve teknike, menaxheriale dhe profesionale të nevojshme për realizimin e Kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- **për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- **për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat,** operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në

fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara do të pranohen si prova.

### 2.3.2 Çertifikimet e Kërkuara

Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikata të vlefshme, me fushë certifikimi që lidhet me objektin e prokurimit, si më poshtë:

| **Standardi** | Përshkrimi | **Statusi** |
|---|---|---|
| **SSH EN ISO 9001** | Sistemet e menaxhimit të cilësisë | Origjinale ose ekuivalente/të barazvlefshme |

*Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*

### 2.3.3 Profilet Profesionale të Kërkuara

Operatori ekonomik duhet të disponojë një staf prej të paktën pesëmbëdhjetë (15) punonjësish. Për verifikimin e përmbushjes së këtij kriteri, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin e listëpagesave, ose dokumentacion ekuivalent për subjektet e huaja (sipas legjislacionit të zbatueshëm në juridiksionin përkatës), që i referohet muajit më të fundit që paraprin afatit për dorëzimin e ofertave.

Ofertuesi duhet të angazhojë staf të kualifikuar, që pasqyron natyrën dhe ekspertizën e nevojshme për realizimin e secilit aktivitet në kuadër të secilës shtyllë, në përputhje me profilet profesionale të mëposhtme:

| Pozicionet e Stafit | Kërkesat për Kualifikim |
|---|---|
| **Partner** | Diplomë Master në financë, ekonomi, administrim biznesi, kontabilitet, bankë, menaxhim, drejtësi, sisteme informacioni me minimumi dhjetë (10) vite eksperiencë profesionale nga data e diplomimit.<br>Minimumi tetë (8) vite eksperiencë të provuar në ofrimin e shërbimeve të konsulencës për institucione financiare, banka zhvillimi, institucione financiare publike evropiane ose subjekte të krahasueshme. |

| | |
|---|---|
| | Dokumentacioni për verifikim: CV e detajuar e stafit në nivel Partner.<br><br>Njohuri të gjuhës angleze, minimumi niveli C1 ose ekuivalent.<br><br>Dokumentacioni për verifikim: Duhet të paraqitet një certifikatë ndërkombëtarisht e njohur e gjuhës angleze ose dokumentacion që vërteton përfundimin e studimeve universitare në gjuhën angleze. |
| **Menaxher/ Drejtues i Lartë** | Diplomë Master në financë, ekonomi, administrim biznesi, kontabilitet, bankë, menaxhim, drejtësi, sisteme informacioni.<br><br>Minimumi gjashtë (6) vite eksperiencë relevante në strategji, planifikim industrial, menaxhim projektesh (PMO), shërbime financiare, institucione publike zhvillimi ose angazhime të krahasueshme.<br><br>Dokumentacioni për verifikim: CV e detajuar e stafit në nivel Manager.<br><br>Eksperiencë e provuar në koordinimin e ekipeve të projektit, duke përfshirë planifikimin e aktiviteteve dhe monitorimin e progresit.<br><br>Njohuri të gjuhës angleze, minimumi niveli C1 ose ekuivalent.<br><br>Dokumentacioni për verifikim: Duhet të paraqitet një certifikatë ndërkombëtarisht e njohur e gjuhës angleze ose dokumentacion që vërteton përfundimin e studimeve universitare në gjuhën angleze. |
| **Fillestar** | Diplomë Bachelor në financë, ekonomi, administrim biznesi, kontabilitet, bankë, menaxhim, drejtësi, sisteme informacioni, inxhinieri ose çdo profesion tjetër të përshtatshëm me natyrën e shërbimit.<br><br>Minimumi tre (3) vite eksperiencë profesionale, të llogaritura nga data e diplomimit.<br><br>Dokumentacioni për verifikim: CV e detajuar e ekspertit Junior.<br><br>Njohuri të gjuhës angleze, minimumi niveli C1 ose ekuivalent. Duhet të paraqitet një certifikatë ndërkombëtarisht e njohur e gjuhës angleze ose |

| | |
|---|---|
| | dokumentacion që vërteton përfundimin e studimeve universitare në gjuhën angleze. |

### 2.3.4 Deklaratë e Angazhimit të Stafit

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë për angazhimin dhe disponueshmërinë e stafit të propozuar për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

**Dispozita të Përgjithshme:**

- **Ofertuesi i renditur i pari duhet të paraqesë origjinalet ose kopje të noterizuara të të gjithë dokumentacionit,përpara publikimit të njoftimit për shpalljen e fituesit dhe fillimit të afateve për paraqitjen e ankimit .**
- **Mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose paraqitja e dokumenteve që përmbajnë informacion të rremë ose të pasaktë, do të përbëjë shkak për skualifikim.**
- **Në rastin e ofertave të paraqitura nga operatorë ekonomikë të huaj, dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë në formën e lëshuar nga vendi përkatës. Në çdo rast, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) rezervon të drejtën të kërkojë sqarime në rast paqartësish që lindin nga forma ligjore e dokumentacionit të operatorit ekonomik të huaj.**

---

Shënim: Sqarim për Operatorët Ekonomikë

Të gjithë operatorët ekonomikë, përfshirë në mënyrë të veçantë operatorët ekonomikë të huaj, kanë të drejtë të kërkojnë sqarime lidhur me dokumentet e tenderit, në përputhje me nenin 75 të Ligjit nr. 162/2020.

Në përputhje me këtë nen, çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një kërkesë për sqarim pranë autoritetit/entit kontraktor, me kusht që kjo kërkesë të paraqitet jo më vonë se 6 (gjashtë) ditë përpara afatit të fundit për dorëzimin e ofertave.

Autoriteti/enti kontraktor duhet të japë përgjigje brenda 3 (tre) ditëve nga data e marrjes së kërkesës për sqarim, me qëllim që t’i mundësojë operatorit ekonomik përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës brenda afatit të përcaktuar.

**Shtojca 10.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________ të operatorit ekonomik ______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | ------------------------------------------------ |
| Numri NIPT/et: | --------------------------------------------------- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | -----------------------------------------------------<br>-- |
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |
| Telefoni: | -----------------------------------------------------<br>- |
| E-mail: | -----------------------------------------------------<br>------ |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

| |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br>• **Informacione për nënkontraktorin** |

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT –i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| **Deklarata** |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*____________________________________ |

| |
|---|
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:<br>__________________________________________________<br>__________________________________________________<br>etj.<br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*__________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*___________________________________________________ |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*__________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*___________________________________________________ |
| Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* __________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* __________________________________________________ |

| |
|---|
| Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br><br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________ |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*______________________________________________________________________ |

**B: DEKLARATA**

**Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

| |
|---|
| Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:<br><br>Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.<br><br>Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër[4].<br><br>Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:<br><br>çmimet;<br>metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;<br>qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,<br>paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.<br><br>Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë. |

[4] *Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*

| |
|---|
| Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj. |

**C: DEKLARATA**

**Mbi Konfliktin e Interesit**

| **Deklarata** |
|---|
